

ZBATIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË POLITIKAT DHE PROCESET PROGRAMORE TË INSTITUCIONEVE





**ZBATIMI I QASJES
SË BAZUAR MBI TË DREJTAT
E NJERIUT NË POLITIKAT
DHE PROCESET PROGRAMORE
TË INSTITUCIONEVE**

Shkup, 2020

Metodologjia

ZBATIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË POLITIKAT DHE PROCESET PROGRAMORE TË INSTITUCIONEVE

Editor:

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Autor:

Tomislav Ortakovski

Redaktore:

Kristina Doda

Recensentë:

Agnes Taibl dhe Katrin Wladasch,
Instituti "Ludwig Boltzman" për të Drejtat e Njeriut,
Austri



Ky publikim u hartua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Ky publikim u hartua me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është në përgjegjësi ekskluzive të Instituti për të Drejtat e Njeriut dhe nuk i pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
1. KONTEKSTI	9
2. IMPLEMENTIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË POLITIKAT DHE PROGRAMET E INSTITUCIONEVE	12
2.1. Faza 1 – Analiza e gjendjes	13
Faza 1, hapi 1 – Grumbullimi i të dhënave / Identifikimi i problemit	14
Faza 1, Hapi 2 – Vlerësimi i bazuar mbi të drejtat e njeriut	15
Faza 1, hapi 3 – Analiza e bazuar mbi të drejtat e njeriut	15
Faza 1, hapi 4 – Përcaktimi i prioriteteve dhe qëllimeve	21
2.2. Faza 2 – Planifikimi dhe dizajni i politikave dhe programeve	22
QBDNJ dhe menaxhmenti i bazuar në rezultate (MBR)	22
2.3. Faza 3 – Implementimi	25
2.4. Faza 4 – Monitorimi dhe evaluimi (M&E)	26
3. QBDNJ DHE BUXHETIMI I BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT	28
4. INDIKATORËT E MONITORIMIT	32
4.1. Llojet e indikatorëve për matjen e realizimit të të drejtave të njeriut	33
Kualitativ dhe kuantitativ	33
Të bazuar në fakte (objektive) dhe të bazuar në qëndrime	33
Indikatorë të performancave dhe indikatorë të harmonizimit	33
Indikatorë dhe kriteri	33
4.2. Matja e realizimit të të drejtave të njeriut	33
Indikatorë strukturorë	34
Indikatorë procesual	34
Indikatorë të rezultatit.....	35
Kritere për seleksionimin e indikatorëve përkatës.....	36
4.3. Vendosija e indikatorëve	36
Kontekstualizimi i indikatorëve	38
BIBLIOGRAFIA	42



HYRJE

Shteti është entitet i ngarkuar primar në realizimin e të drejtave të njeriut të poseduesve të të drejtave në territorin e vet. Sot, kjo mënyrë e të kuptuarit të rolit të shtetit, në shtete të ndryshme është e ndryshme. Pavarësisht gjendjeve konkrete në një shtet të caktuar, të drejtat e njeriut janë kategori e mbrojtur ndërkombëtare ndërsa standardet për të drejtat e njeriut janë vendosur në instrumentet ndërkombëtare të cilat në detaje e rregullojnë realizimin e të njëjtave, si dhe minimumin e niveleve të pranueshme për realizimin e tyre.

Publikimi është dedikuar që të njëjtin ta përdor struktura e përgjithshme e pushtetit – pushteti qendror dhe lokal, ministritë, agjencitë dhe drejtoritë e ndryshme, si dhe autoritetet e tjera publike të cilat kanë kompetenca përmes të cilave, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, realizohet ndikim mbi jetët e poseduesve të të drejtave. Qëllimi i publikimit është prezantimi i qasjes metodologjike për atë se si të dizajnohen dhe si të zbatohen politikat dhe programet të cilët do të kenë ndikim esencial pozitiv mbi të drejtat e njeriut për të gjithë, duke i përfshirë të margjinalizuarit, të harruarit dhe të padukshmit.

Metodologjia e zhvilluar dhe indikatorët e prezantuar në vijim janë dedikuar për përdorim nga të punësuarit në organizata të ndryshme të pushtetit të përfshirë në cilëndo qoftë nga fazat e përshkruara më poshtë, pavarësisht nivelit në të cilin janë në strukturën organizative. Megjithatë, implementimi i QBDNj është kompleks dhe operacion ekipor, i cili përfshinë shumë përfaqësues të pushtetit, përkatësisht të autoriteteve, si dhe faktorë të tjerë shtetërorë dhe joshtetërorë. Edhe pse ka mbivendosje të konsiderueshme midis implementimit të QBDNj në politikat dhe programimin, nga njëra anë, dhe ofrimit të shërbimeve, nga ana tjetër, publikimi kryesisht i dedikohet të parës. Qasja metodologjike për implementimin e QBDNj sa i përket dhënies së shërbimeve duhet të zhvillohet në mënyrë plotësuese, duke i pasur parasysh specifikat e shumta të realizimit të të drejtave të njeriut gjatë ofrimit të shërbimeve publike. Nga aspekti i ofrimit të shërbimeve publike, në linjë me QBDNj, ky publikim thjeshtë mund të përdoret si pikë referimi.

Të drejtat e njeriut, në formën e tyre aktuale, janë rezultat të evaluimit historik dhe përdërisa OKB nuk filluan t'i adresojnë në nivel sistemor dhe të insistojnë që shtetet t'i pranojnë detyrimet për realizimin e të drejtave të njeriut, këto të drejta ishin pjesë e çështjeve të brendshme të çdo shteti. Edhe pse aktet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, ekzistojnë që nga fundi i shekullit XIX, pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas themelimit të OKB-së në vitin 1945, zhvillimi i të drejtave të njeriut shënoi zhvillim të madh. Vet Karta e OKB-së specifikon se të drejtat e njeriut janë esenca e impenjimeve të saj (neni 1.3). Përmes OKB-së, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut nga viti 1948, nëntë instrumentet kyç të OKB-së për të drejtat e njeriut dhe protokollat e tyre obsional, si dhe një sërë konferencash dhe deklarata të cilat adresojnë çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, korniza ndërkombëtare legjislative për të drejtat e njeriut evoluoi në drejtimin e ruajtjes dhe mbrojtjes së integritetit dhe dinjitetit të individëve, përmes vendosjes së detyrimeve për shtetet që t'i mbrojnë të drejtat e të gjithë atyre të cilët jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e tyre. Ky korpus i instrumenteve të cilët i rregullojnë të drejtat e njeriut, e përkufizojnë edhe përfshirjen dhe thellësinë e të drejtave të cilat shteti e ka për detyrë që t'i mbroj.

Instrumentet ndërkombëtare i vendosin standardet minimale të cilat çdo shtet e ka për detyrë t'i respektoj sa i përket mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, ato i përcaktojnë të drejtat e poseduesve të të drejtave dhe detyrimet e bartësve të detyrave që t'i mbrojnë këto të drejta. Këto detyrime klasifikohen në tri kategori:

Respektimi i të drejtave të njeriut	E nënkupton detyrimin e shteteve dhe të bartësve të detyrimeve të mos ndërhyjnë në gëzimin e të drejtave të njeriut.
Mbrojtja e të drejtave të njeriut	E nënkupton detyrimin e shteteve dhe të bartësve të detyrave të ndërmarrin hapa përmes të cilëve do të sigurojnë që palët e treta të mos e pengojnë gëzimin e të drejtave të poseduesve të të drejtave.
Realizimi i të drejtave të njeriut	E nënkupton detyrimin e shteteve dhe të bartësve të detyrave të jenë aktivë dhe të ndërmarrin hapa progresiv për realizimin e të drejtave të njeriut. Ky detyrim e përfshinë: detyrimin e shtetit të krijoj kushte për realizimin dhe kërkesën e të drejtave nga ana e poseduesve të të drejtave, si dhe detyrimin që të intervenoj në mënyrë të drejtpërdrejt dhe ta mundësoj gëzimin e të drejtave të njeriut në rastin kur një gjë e këtillë nuk mund të realizohet ndryshe.

Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut është një metodë e zhvilluar në kuadër të OKB-së si mënyrë e shndërrimit të detyrimeve të cilat burojnë nga instrumentet për të drejtat e njeriut në rezultate konkrete në terren, dhe me këtë duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejt për ndryshime të qëndrueshme në jetët e poseduesve të të drejtave. Nga pikëpamja kronologjike, zhvillimi i QBDNj është iniciuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së në vitin 1997, i cili i thirri të gjitha agjencitë e OKB-së që t'i meinstrimizojnë të drejtat e njeriut në aktivitetet e tyre, në kuadër të mandateve përkatëse. UNDP, në vitin 1998, e aprovoi politikën për "Integrimin e të drejtave të njeriut në zhvillimin e qëndrueshëm të njeriut". Ndërsa raportet pasuese për të drejtat e njeriut, nga viti 2000 dhe 2002¹, e vunë në dukje se zhvillimi njerëzor është esencial, për realizimin e plotë të të drejtave të njeriut, ndërsa të drejtat e njeriut janë esenciale për arritjen e zhvillimit integral të njeriut. Në këtë mënyrë të drejtat e njeriut dhe zhvillimi i njeriut ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejt dhe kanë vizion dhe synim të përbashkët.

Nga ana tjetër, në vitin 2003, agjencitë e sistemit të OKB-së e miratuan **Të kuptuarit e ndërsjellë të qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut**, që nënkupton se "gjatë përdorimit të qasjes së bazuar mbi të drejtat në programimin dhe bashkëpunimin zhvillimor, çdo aktivitet ka për qëllim të kontribuoj në mënyrë të drejtpërdrejt në realizimin e një ose disa të drejtave të njeriut". (UNDP, Argjentinë, viti 2011, faqe 11-12)

Pikërisht dokumenti i fundit i specifikon **tre atributet esenciale të QBDNj në programimin e aktiviteteve** të OKB-së dhe agjencive të saj (UNSDG, 2003):

- Të gjitha programet e bashkëpunimit zhvillimor, politikave dhe asistencës teknike duhet ta **avancojnë realizimin e të drejtave të njeriut**, konform Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe konform instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut.
- Standardet e përfshira për të drejtat e njeriut, si dhe parimet të cilat burojnë nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet e tjera ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, e **udhëzojnë gjithë bashkëpunimin zhvillimor dhe programimin** në të gjithë sektorët dhe në të gjitha fazat e proceseve programore.
- Bashkëpunimi zhvillimor kontribuon në zhvillimin e kapaciteteve të bartësve të detyrave me qëllim që **t'i përmbushin detyrimet e tyre** dhe/ose të poseduesve të të drejtave që t'i **realizojnë të drejtat e tyre**.

¹ <http://hdr.undp.org/en/global-reports>

Këto tri baza janë edhe baza për implementimin e QBDNj në kuadër të institucioneve demokratike dhe proceseve të tyre të miratimit dhe implementimit të politikave dhe programeve.

Në këtë kontekst të drejtat e njeriut nënkuptohen si “program i cili i udhëzon dhe i specifikon politikat publike të shteteve dhe ndihmon në fuqizimin e institucioneve demokratike, veçanërisht në kohë tranzicioni ose në rastet e ekzistimit të demokracive jo të plota dhe të dobëta”. (Abramoviç, 2006, faqe 38)

1. KONTEKSTI

Shteti është subjekti kyç mbi të cilin bien përgjegjësitë e ndërmarra përmes instrumenteve të ratifikuara ndërkombëtare. Marrë në përgjithësi, këto detyrime nënkuptojnë që shteti ta siguroj respektimin, mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut për poseduesit e të drejtave në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Nga prizmi i poseduesve të të drejtave, këto detyrime paraqesin përgjegjësi të cilat shteti i ka ndaj tyre, ndërsa ata vet e kanë të drejtën papengesa t'i realizojnë të drejtat e tyre të njeriut, si dhe të kërkojnë që shteti të siguroj kushte për realizimin e tyre. Pastaj, këto detyrime kalojnë edhe në funksionimin e sektorëve të tjerë të shtetit, siç janë bizneset dhe sektori qytetar. Këto entitete, në kuadër të veprimit të tyre, duhet ta inkorporojnë korpusin e të drejtave të njeriut dhe implikimet në raste konkrete, duke e pasur parasysh ndikimin e tyre të drejtpërdrejt në jetën e poseduesve të të drejtave dhe potencialet e mosrespektimit, shkeljes, madje edhe pengimi aktiv i gëzimit të të drejtave të njeriut.

Maqedonia e Veriut ka aderuar në tetë nga nëntë instrumentet kyç për të drejtat e njeriut², me përjashtim të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre³. Kjo nënkupton se shteti i ka ndërmarrë detyrimet që t'i respektoj, mbroj dhe realizoj të drejtat e njeriut të qytetarëve, më së paku në mënyrën dhe vëllimin e parashikuar në këto dokumente. Nga ana tjetër, kjo nënkupton se poseduesit e të drejtave kanë mundësi dhe duhet t'i kenë si përgjegjës shtetin dhe bartësit e tjerë të detyrave, si dhe të kërkojnë prej tyre mënyra të përgjithshme dhe konkrete të veprimit për realizimin e të drejtave të tyre.

Përveç në konventat e lartpërmendura, por edhe në marrëveshjet dhe mekanizmat ekzistues ndërkombëtarë rajonal⁴ të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt janë të zbatueshme, si pjesë e legjislacionit nacional, Maqedonia e Veriut i mbron të drejtat e njeriut të poseduesve të të drejtave edhe me Kushtetutë, me ligjet dhe me aktet nënligjore. Kushtetuta e afirmon respektimin e të drejtave të njeriut përmes vendosjes së themeleve për realizimin e tyre nga poseduesit e të drejtave, ndërsa përmes kësaj, i detekton edhe detyrimet të cilat bartësit e detyrave i kanë ndaj tyre. Pastaj, Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (LPMD) nga viti 2010, e vendos bazën për barazi dhe ndalim të diskriminimit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Ligji i ri LPMD, teksti i

-
- 2 Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Gruas; Konventa për Mbrojtje nga Tortura dhe Trajtimi Johuman, ose Poshtëruar ose Ndëshkimi; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme; dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- 3 Më shumë për statusin për aderimin e Maqedonisë së Veriut në instrumentin e OKB-së për të drejtat e njeriut, si dhe për statuset e vendeve të tjera, në nivel global, shih [indicators.ohchr.org](https://www.ohchr.org)
- 4 Siç është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Karta e Rreviduar Sociale Evropiane, si dhe një sërë të marrëveshjeve ndërkombëtare evropiane për të drejtat e njeriut dhe rastet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për më shumë informacione lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në kuadër të Këshillit të Evropës, shih: <https://www.coe.int/en/web/portal/home>.

të cilit është finalizuar dhe pritet miratimi i tij në një të ardhme të shpejtë, në masë të konsiderueshme do ta avancoj mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe infrastrukturën e tij. Të drejtat e njeriut, si koncept horizontal, dhe mbrojtja e tyre, janë përfshirë edhe në një sërë ligje të tjerë tematikë dhe në akte nënligjore në nivel nacional, si dhe në aktet nënligjore dhe vendimet në nivel lokal. Si të këtilla, të drejtat e njeriut e paraqesin bazën mbi të cilën ndërtohet shoqëria.

Agjencitë e ndryshme të OKB-së, si në nivel global, ashtu edhe në nivelin e vendeve në të cilat janë të pranishme, e implementojnë QBDNj në të gjitha aspektet dhe në të gjitha fazat e punës. Programet dhe aktivitetet e tyre, pas të kuptuarit të përbashkët të qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut nga viti 2003, e përfshijnë QBDNj si pjesë integrale e cila siguron që rezultatet nga aktivitetet t'i ndjejnë edhe poseduesit më të marginalizuar dhe të përjashtuar të të drejtave.

Nga aspekti procesual, planifikimi, miratimi dhe implementimi i politikave dhe programeve në institucionet shtetërore nuk ka diferenca esenciale nga proceset e njëjtë në kuadër të agjencive të OKB-së. Secila fazë përmban elemente kyç të cilët janë të përbashkët edhe për OKB edhe për institucionet nacionale. Së këtejmi, metodat dhe mënyrat e realizimit të objektivave ndajnë elemente të përbashkëta. Nga kjo perspektivë, edhe pse ka diferenca të konsiderueshme midis institucioneve të caktuara dhe aparatit të përgjithshëm shtetëror, nga njëra anë, dhe struktura organizative individuale ose e përgjithshme e OKB-së dhe agjencive, nga ana tjetër, QBDNj është njëlloj e zbatueshme (përmes qasjes së dizajnuar individuale përkatëse) dhe ka potencial ta transformoj punën e aparatit shtetëror. Aq më shumë, ka potencial ta transformoj mënyrën me të cilën bartësit e detyrave i përmbushin detyrimet e tyre, ndërsa me këtë ta transformoj jetën madje edhe të poseduesve të marginalizuar dhe të përjashtuar të të drejtave.

Për nevojat e këtij publikimi iu qasëm një numri të madh të institucioneve qendrore, përmes pyetësorit të dizajnuar që t'i vlerësoj kapacitetet e institucioneve që në mënyrë sistemore ta implementojnë QBDNj, si dhe të të punësuarve që për çdo ditë ta përdorin në punën e tyre. Duke i ditur kufizimet e qasjes, realizuam edhe intervista gjysmë të strukturuar me bartësit e detyrave në pozita të larta në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Edhe pse pjesa më e madhe e institucioneve të cilëve ua dërguam pyetësorin nuk iu përgjigjën të njëjtë, megjithatë patëm sukses të kemi një pasqyrë përkatëse të gjendjeve të përgjithshme edhe sa u përket kapaciteteve të bartësve të detyrave lidhur me QBDNj. Megjithatë, akti i mos përgjigjes ndaj pyetësorit nga një numër i madh i institucioneve është indikator për responsivitet të bartësve të detyrave, por edhe për ta kuptuar konceptin themelor të QBDNj⁵.

Katër konkluzione kryesore rezultojnë nga këto aktivitete:

1 QBDNj është identifikuar në nivel të ulët nga institucionet dhe aq më pak është përdorur në mënyrë sistemore. *Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së, në institucione të caktuara, përdoren si udhëzues në krijimin e dokumenteve strategjike, politikave dhe legjislacionit, ndërsa përdorimi i QBDNj si kornizë konceptuale varet vetëm nga njohuritë individuale dhe aftësitë e bartësve të detyrave të cilët i zhvillojnë dhe udhëzojnë proceset. Është interesante e dhëna se ministrinë të cilat iu përgjigjën pyetësorit, në korniza të caktuara, i kanë harmonizuar proceset programore me parimet dhe fazat e Menaxhmentit të bazuar në rezultate. Por, një gjë e këtillë nuk mund të thuhet edhe për QBDNj, edhe pse janë evidente disa nisma të caktuara të implementimit të Parimeve për të drejtat e njeriut në punën e tyre programore.*

⁵ Institucione të cilat iu përgjigjën pyetësorit: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Drejtësisë.

Megjithatë, qasja e strukturuar nuk është praktikuar.

Në institucionet e nivelit të lartë ka ndërgjegjësime më të madh për detyrimet të cilat bartësit e detyrave i kanë për realizimin e të drejtave të njeriut. Gjatë zhvillimit të politikave dhe programeve konkrete në të cilat janë përfshirë këta individë, QBDNj (edhe pse i pa strukturuar), e gjen rrugën e vet në faza të ndryshme dhe në një nivel të caktuar inkorporohet në proceset. Ky lloj i presionit top-down mund të jetë i dobishëm gjatë programimit të hapave të ardhshëm në avancimin e zbatimit të QBDNj në proceset e institucioneve.

Nga ana tjetër, duke e pasur parasysh nivelin e caktuar të aspektit sensitiv për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut midis ekipeve operative të institucioneve, si dhe ekzistimi bazik i ndërgjegjes për nevojën e përfshirjes së QBDNj në fazat programore, është e evidente se akoma është herët të flasim për presionin e brendshëm bottom-up, i cili do të kontribuonte në evoluimin më të shpejtë gjatë implementimit të QBDNj.

2 Ekziston nevojë e theksuar për aktivitete lidhur me ndërgjegjësimin për QBDNj.

Elementi i vetëm i cili ishte i përbashkët midis përgjigjeve të pyetësorit dhe bartësve të intervistuar të detyrave konsiston me atë se niveli i ndërgjegjësimit në institucionet për ekzistimin e strukturuar të QBDNj është i pakënaqshëm. Vërejtja e përgjithshme ka të bëjë me atë se edhe pse një pjesë e të punësuarve i implementojnë elementët e QBDNj në fazat programore si rezultat i përvojave profesionale, megjithatë janë të kufizuar në nivel individual dhe me shembuj konkret. Së këtejmi, një pjesë e madhe e bartësve të detyrave nuk janë të njoftuar me QBDNj.

Këqyrja e këtillë në dinamikën e funksionimit të ministrive është shumë interesante dhe e vë në dukje ekzistimin e disbalancit sa i përket ndërgjegjësimit, njohurive dhe aftësive për QBDNj midis niveleve të ndryshme, në kuadër të vet institucioneve, si dhe midis institucioneve të ndryshme. Spektri i targetuar i aktiviteteve për ndërgjegjësim, në partneritet me institucionet, mund të kontribuoj në rritjen e të kuptuarit të QBDNj, si dhe në rritjen e interesimit për përvetësimin e njohurive dhe aftësive profesionale për implementimin e QBDNj.

3 Kapacitetet e bartësve të detyrave kanë nevojë emergjente për zhvillim dhe superstrukturë. Nëse dëshirojmë të ndërtojmë institucione responsive ndaj nevojave të poseduesve të të drejtave, të cilat një gjë të këtillë do ta bëjnë në mënyrë të vazhdueshme dhe në të gjitha fazat e punës, medoemos duhet të sigurojmë njohuri dhe aftësi. Kapacitetet ekzistuese për implementimin e QBDNj janë në nivel shumë të ulët dhe së këtejmi rezultatet në të vërtetë aspak nuk befasojnë. Nga aktivitetet e zbatuara u bë e qartë se nevojiten të tri llojet e trajnimeve për bartësit e detyrave – trajnime fillestare, të avancuara dhe për ekspertë. Këto dy të fundit do të ishin jashtëzakonisht të rëndësishme për bartësit e detyrave, të cilët do ta kenë rolin që të sigurojnë implementim horizontal të QBDNj në të gjitha proceset programore të institucionit konkret.

4 Pika të centralizuara për koordinimin e zbatimit të QBDNj në institucione (pika fokale, seksione programore, sektorë programor – ky i fundit veçanërisht kur ekziston nevojë më e madhe koordinuese, si në Qeveri). Përmes intervistave të realizuara përfaqësuesit e institucioneve e vunë në dukje atë se për qasje strukturore në implementimin e QBDNj, në çdo institucion, duhet të ekzistoj person i caktuar ose seksion i cili do ta siguroj implementimin e QBDNj në të gjitha politikën dhe programet në kompetencë të institucionit në fjalë. Kjo dhe zgjidhje të ngjashme praktikohen edhe në agjencitë e OKB-së, në kuadër të seksioneve/sectorëve përkatës programor. Theksi i qasjes së këtillë të centralizuar ka të bëjë me ushtruesit e detyrave, të cilët janë pika fokale ose pjesë e seksioneve/sectorëve, që janë profesionistë në meinstremizimin e QBDNj, në kuadër të të gjitha fazave të punës dhe ata i kontrollojnë


proceset e miratimit të politikave dhe programeve, si dhe atë se sa të njëjtat bazohen në QBDNJ. Në mënyrë plotësuese, në organizata të ndryshme ndërkombëtare edhe brenda edhe jashtë sistemit të OKB-së, këto seksione/sectorë programorë kanë përgjegjësi plotësuese, natyra e të cilave kryesisht varet nga angazhmanet konkrete të organizatave, por mes tjerash, e përfshijnë edhe meinstremizimin sipas gjinisë, aftësive të kufizuara dhe të rinjve në programimin.

2. IMPLEMENTIMI I QASJES SË BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT NË POLITIKAT DHE PROGRAMET E INSTITUCIONEVE

Në shoqërinë tonë shteti akoma e ka rolin kryesor në proceset e miratimit dhe implementimit të politikave dhe programeve. Edhe pse në këto procese është evidente përfshirja më e madhe esenciale e sektorit qytetar dhe sektorit të biznesit, megjithatë ekziston hapësirë e madhe dhe nevojë për avancim. Ky është rezultat i tendencës institucionet e pushtetit t'i perceptojnë aktorët joshitetërorë, si autoritete të jashtme në sistemin e qeverisjes dhe administrimit, por edhe në pranimin ekzistues të tezës se shteti është qëllim në vetvete. Kjo mënyrë e të kuptuarit është në kundërshtim të drejtpërdrejt me konceptet bashkëkohore të të drejtave të njeriut dhe për rolin e shtetit. Nga ana tjetër, sipas tyre, shteti dhe bartësit e tjerë të detyrave, në çdo nivel, kanë detyrim t'i promovojnë, mbrojnë dhe realizojnë të drejtat e njeriut të poseduesve të të drejtave. Kjo e nënkupton themelin e zhvillimit të qëndrueshëm të një shoqërie dhe është lajtmotivi i QPDNJ.

Në të vërtetë, krijimi i politikave dhe programeve për zhvillimin nacional bazohet në përgjigjet e tri pyetjeve: çka duam të arrijmë, si një gjë të këtillë duam ta arrijmë dhe për kë e bëjmë këtë. QPDNJ i udhëzon proceset të cilët duhet t'u përgjigjen këtyre pyetjeve në mënyrë që do t'i lidhë me shkaqet esenciale për gjendjet në të cilat gjenden disa grupe të caktuara të personave me realitetin strukturor në të cilin janë paraqitur shkaqet. Përfundimisht, përmes përdorimit të QBDNJ, në të gjitha fazat e procesit të krijimit dhe implementimit të politikave dhe programeve, shteti i adreson ato shkaqe në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa kjo kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm njerëzor dhe shoqëror.

Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut, shkurtimisht, është integrim sistematik i parimeve të të drejtave të njeriut në punën e përditshme në drejtim të krijimit të politikave dhe mbështetjes së punës programore në nivel nacional dhe lokal.



2.1. Faza 1 – Analiza e gjendjes

Procesi kryesor i planifikimit të proceseve dhe aktiviteteve si dhe përfshirja esenciale e të gjithë faktorëve relevantë, konform QBDNj, bazohet në arritjen e rezultateve të dëshirueshme dhe në qëndrueshmërinë e tyre në afat të gjatë. Për një gjë të këtillë nevojitet kohë dhe resurse, por edhe përfitimet nga zbatimi i të njëjtave janë të shumëfishta.


Faza e Analizës së gjendjes është faza më e rëndësishme nga aspekti i QBDNj. Këtu shihet njohja e QBDNj dhe teknikat e implementimit të standardeve dhe parimeve të të drejtave të njeriut në proceset e krijimit të politikave dhe programeve. Nga njëra anë sa më mirë t'i inkorporojmë standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut, në katër hapat kryesorë të kësaj faze, nga ana tjetër, do të kemi pasqyrë më të saktë për gjendjet reale në terren dhe do të kemi një bazë më solide për planifikimin e aktiviteteve përkatëse. Së këtejmi, kjo do të rezultojë me rezultate të qëndrueshme afatgjata.

Prandaj, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ekipi i cili do ta zbatoj këtë fazë të ketë njohuri përkatëse për të drejtat e njeriut dhe QBDNj, qofshin ato njohuri praktike ose teorike – sipas mundësisë që të dyja. Në këtë fazë ekipi duhet t'u përgjigjet pyetjeve si vijon (adoptuar nga UNDP, Vietnam, 2009):

- Çka ndodhë, kujt i ndodhë dhe pse ndodhë?
- Kush janë poseduesit e të drejtave dhe kush janë bartësit e detyrave të cilët e shkaktojnë ose janë të prekur nga problemi?
- Cilat janë pengesat me të cilat poseduesit e të drejtave ballafaqohen gjatë realizimit të të drejtave të tyre?
- Pse bartësit e detyrave nuk i përmbushin detyrimet e tyre?
- A ekziston zgjidhje relevante ligjore e cila e rregullon çështjen konkrete?
- A ekziston dallim midis detyrimeve ndërkombëtare, të cilat i ka ndërmarrë shteti, legjislacionit aktual nacional dhe implementimit në terren?

- Cilat janë efektet nga (mos)implementimi i zgjidhjeve ligjore mbi poseduesit e të drejtave?
- Cilët janë rolet e bartësve të detyrave, në të gjitha nivelet, dhe si ndikojnë ato në perpetuimin e problemeve?

Kjo fazë zbatohet përmes 4 hapave kryesorë.



Faza 1, hapi 1 – Grumbullimi i të dhënave/identifikimi i problemit

Hapi i parë ka të bëjë me shqyrtimin e të gjitha dokumenteve relevante, të dhënave dhe informacioneve që i kemi në dispozicion. Këtu duhet të përfshihen të gjitha dokumentet e krijuara nga cilido qoftë faktor, jo vetëm nga institucionet. Është e nevojshme që problemi të kuptohet nga disa këndvështrime dhe perspektiva, dhe veçanërisht nga këndvështrimi i grupeve të marginalizuara dhe të përjashtuara. Ky shqyrtim duhet t'i përfshijë burimet e ndryshme të informacioneve (madje edhe ato kundërthënëse), raportet e ndryshme, indikatorët dhe dokumentet nga faktorë ndërkombëtarë, nacional, shtetërorë dhe joshtetërorë.

Në procesin e identifikimit të problemit grumbullojmë informacione të ndryshme për proceset dhe karakteristikat relevante administrative; korniza ligjore dhe strategjitë ekzistuese, programet dhe planet; konkluzionet dhe rekomandimet e autoriteteve kontraktuese dhe të raportuesve special; të dhënat dhe analizat e institucioneve nacionale për të drejtat e njeriut dhe ombudsmanëve; si dhe analizat, konkluzionet dhe rekomandimet e organizatave qytetare.

Të gjitha informacionet duhet të klasifikohen sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, vend-ndodhjes gjeografike, aftësive të kufizuara etj. (përkatësisht në cilëndo qoftë bazë të diskriminimit të marrëveshjeve ndërkombëtare (UNDP, Argjentinë, 2011).

Pas përfundimit të kompilimit të të dhënave, mund të përdoren edhe mekanizma të tjerë, me qëllim që më mirë të përcaktohet lidhja e problemit në fjalë me të drejtat e njeriut: intervista, pyetësorë dhe grupe të synuara. Këto aktivitete plotësuese na mundësojnë t'i përcaktojmë strategjitë e veprimit, mekanizmat dhe faktorët e tjerë relevantë të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt mbi realizimin e të drejtave të njeriut.

Me një qasje të këtillë sigurohet të kuptuarit më i mirë dhe më i plotë i gjendjes përmes disa dimensioneve: politikë, ekonomi, social, juridik, kulturor, historik dhe zhvillimor.

Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, nevojitet që ekipi i cili do të ngarkohet me grumbullimin e të dhënave dhe me implementimin e aktiviteteve shtesë, të jetë shumë mirë i njoftuar me konceptin e të drejtave të njeriut dhe të ketë përvojë në fushën e programimit, konform QBDNj. Nëse ekipi apo disa anëtarë të tij nuk kanë nivel adekuat të njohurive, atëherë duhet të organizohen trajnime të avancuara, të cilat do të fokusohen në ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut dhe për standardet dhe parimet e tyre, për mënyrat e shkeljes së tyre dhe/ose kufizimit, mekanizma për mbrojtje, implikime reale dhe potenciale në jetën e përditshme, si dhe për identifikimin e shpejtë të njerëzve dhe grupeve të cilët janë më të ekspozuar që të preken nga shkeljet e këtilla.

Faza 1, hapi 2 – Vlerësimi i bazuar mbi të drejtat e njeriut

Pas përcaktimit të problemeve dhe mangësive emergjente, ekipi i qaset identifikimit dhe vlerësimi të të drejtave përkatëse të njeriut, mbi të cilat ato kanë ndikim, të cilat janë pamundësuar ose kufizuar. Këtu identifikohen dhe vlerësohen edhe poseduesit përkatës të të drejtave dhe bartësit e detyrave, si dhe harmonizimi i gjendjes në letër vis-a-vis gjendjes në teren. Kjo, mes tjerash, nënkupton të përcaktohet se a ka mangësi në normat ligjore dhe në mbrojtjen e të drejtave konkrete, ose nga ana tjetër ka mangësi gjatë implementimit. Ky nën-hap në aspektin primar i vuri në dukje fushat dhe të drejtat konkrete të njeriut të pamundësuar dhe të kufizuara dhe duhet të merret parasysh se edhe shembujt dhe praktikat pozitive duhet të identifikohen. Ato, në të ardhmen, do të mund të përdoren si shembuj dhe praktika më të mira dhe si pjesë të aspekteve të ndryshme programore të politikës ose programit konkret, si dhe sa u përket politikave dhe programeve të ardhshme.

Qëllimi i vlerësimi konsiston me përcaktimin se ku dhe në ç' masë ekzistojnë sfida zhvillimore dhe ku ndikojnë të njëjtat. Vlerësimi duhet t'i përgjigjet pyetjes: "Çka ndodh?", "Kujt i ndodh?" dhe "Ku ndodh?". Gjatë këtij aktiviteti është e domosdoshme të përdoret qasja participative, me qëllim të përfshirjes së problemeve, sfidave, përvojave dhe pikëpamjeve të grupeve të ndryshme të margjinalizuara dhe përjashtuara.

Siguroni se grupet në vijim do t'i merrni parasysh dhe do t'i përfshini në vlerësimin (në përputhje me nevojat konkrete) dhe se të dhënat do të disagregohen në mënyrë përkatëse (lista është vetëm si model dhe mund të plotësohet dhe zvogëlohet, në përputhje me nevojat):

- Persona me aftësi të kufizuara dhe prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Persona të cilët jetojnë në varfëri;
- Presona të moshuar;
- Refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda vendit;
- Persona pa dokumente personale dhe persona të pa evidentuar;
- Gra, duke i përfshirë veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunës në familje dhe gra punëtore - seksuale;
- Grupe minoritare, duke i përfshirë minoritetet etnike dhe kulturologjike;
- Romë, si kategori e veçantë multidimensionale;
- Persona me orientim të ndryshëm seksual, duke e përfshirë këtu popullatën LGBTI;
- Fëmijë në rrugë dhe prindër të fëmijëve në rrugë;
- Grupe të margjinalizuara, etj.

Faza 1, hapi 3 – Analiza e bazuar mbi të drejtat e njeriut

Analiza e bazuar mbi të drejtat e njeriut fillon me analizën e të dhënave të grumbulluara, me qëllim të përcaktimit të sfidave zhvillimore në fushat prioritare në të cilat duhet të ndërmerret veprimi. Këtë e bëjmë duke iu përgjigjur tre grupeve të pyetjeve, të cilat në të vërtetë do të prodhojnë tri analiza. Edhe pse kjo analiza në tri hapa mund të bëhet në cilëndo qoftë fazë të ndonjë cikli të caktuar programor, kur analizohet gjendja, ajo është e domosdoshme.

Analiza në tri hapa:

- 1 Analiza kauzale** -> Pse? Për cilat të drejta bëhet fjalë? Shpjego pse ka problem.
- 2 Analiza e roleve** -> Kush duhet të ndërmarr diçka? Kush janë poseduesit e të drejtave? Kush janë bartësit e detyrave? Kush duhet të ndërmarr diçka dhe çka është ajo?
- 3 Analiza e boshllëkut të kapaciteteve** -> Çka u nevojitet që të ndërmarrin veprim? Cilat boshllëqe ekzistojnë në kapacitetet tek bartësit e detyrave që t'i realizojnë detyrimet e tyre? Cilat boshllëqe ekzistojnë tek poseduesit e të drejtave në mënyrë që t'i kërkojnë dhe t'i realizojnë të drejtat e tyre?

Analiza kauzale

Analiza kauzale është një teknikë për identifikimin e shkaqeve të drejtpërdrejta, themelore dhe esenciale të një problemi të caktuar zhvillimor. Përmes kësaj analize do t'i përgjigjemi pyetjes përmes cilave të drejta mund të shpjegojmë pse ekziston problemi. Këtu fokusi vendoset mbi shkaqet esenciale të problemeve zhvillimore dhe mbi modelet e diskriminimit.


Kjo analizë ndihmon në të kuptuarit e shkaqeve të shumta, të ndërlidhura dhe të ndërvarura të cilat kontribuojnë në drejtim të problemit të identifikuar zhvillimor. Kjo teknikë përbëhet nga krijimi i pemës/trekëndëshit të problemit, e që është një mekanizëm i dobishëm përmes të cilit i hartëzojmë të gjitha kushtet, gjendjet dhe shkaqet që kontribuojnë në drejtim të problemit, si dhe mënyrat në të cilat do t'i adresojmë të njëjtat. Ky mekanizëm përdoret në punë grupore, duke filluar me stuhinë e ideve, dhe kështu përmes diskutimit të definohet struktura e pemës në fjalë. Gjithsesi se ekipi i cili do të marrë pjesë duhet të jetë i edukuar për konceptin e të drejtave të njeriut dhe brenda mundësive për qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut, si dhe për përdorimin e të gjitha burimeve relevante të të dhënave.

Pema/trekëndëshi i problemit përbëhet nga katër nivele të cilët përmbajnë lloje të ndryshme të shkaqeve dhe manifestimin e problemit i cili e pengon gëzimin e një të drejte të caktuar të njeriut. Analiza fillon nga manifestimi kryesor i problemit dhe zbret poshtë, duke e identifikuar hierarkinë e shkaktarëve. Fillimisht analizohet ndërvarësia e manifestimit të problemit dhe shkaqet e drejtpërdrejta, pastaj fokusi vihet mbi marrëdhëniet midis shkaqeve të drejtpërdrejta dhe themelore, dhe në fund të përcaktohen marrëdhëniet midis shkaqeve themelore dhe esenciale, si dhe shkaqet esenciale (UNICEF, Finlandë, 2013). Në këtë mënyrë krijojmë hartë e cila na tregon se çfarë efekti do të ketë shmangia e një shkakut të caktuar esencial mbi nivelet më të larta të shkaqeve dhe mbi manifestimin e problemit.

Niveli i manifestimit ndryshe quhet edhe niveli i sfidës ose niveli i të drejtës së porealizuar, varësisht nga ajo se kush e përdor këtë teknikë dhe çka dëshiron të arrij. Ky nivel e pasqyron rezultatin e fundit përkatësisht të drejtën ose të drejtat që nuk respektohen si pasojë e niveleve të shkaqeve më poshtë. Manifestimi është përmbledhje kualitative e të tri niveleve shkaktuese, ku çdo nivel shkaktues ndikon në mënyrë të ndryshme mbi manifestimin dhe mbi faktorët e ndryshëm të cilët janë pjesë të problemit të identifikuar.

Shkaqet e drejtpërdrejta janë ato të cilat kanë ndikim tejet të drejtpërdrejt mbi njerëzit, familjet dhe komunitetet dhe të cilat në mënyrë tejet të drejtpërdrejt e shkaktajnë manifestimin të cilin mund ta shohin të gjithë. **Shkaqet themelore** janë ato shkaqe të cilat i definojnë shkaqet e drejtpërdrejta dhe të cilat kontribuojnë në manifestimin e problemit. Ato më së shpeshti janë pasojë e implementimit të politikave, ligjeve, si dhe të aksesit të resurseve. **Shkaqet esenciale/strukturore** janë ato të cilat janë thuaja se të padukshme dhe të cilat zbulojnë gjendje për tejkalimin e të cilave nevojiten intervenime afatgjata, me qëllim të ndryshimit të qëndrimeve shoqërore dhe marrëdhënieve në nivele të ndryshme.

**FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA NUK FITOJNË
ARSIM CILËSOR DHE JANË TË NEGLIZHUAR NGA
PROCESET BASHKËKOHERE TË PUNËS**



MANIFESTIMI

SHKAQE TË DREJTPËRDREJTA

SHKAQE THEMELORE

SHKAQE ESENCIALE

Analiza e roleve

Në bazë të analizës kauzale, analiza e roleve i identifikon palët e interesuara, përkatësisht përgjigjet në: 1. Kush janë poseduesit e të drejtave që janë të prekur me problemin?, 2. Kush janë bartësit e detyrave? dhe 3. I kujt është detyrimi të ndërmarr veprim për zgjidhjen e problemit të identifikuar?. Kjo analizë e definon se kush, çfarë lloji të detyrimeve ka, ndaj kujt, dhe veçanërisht i përkushton vëmendje shkaqeve të identifikuara esenciale/struktorore. Për identifikimin e detyrimeve është jashtëzakonisht e rëndësishme të kontrollohen detyrimet të cilat shteti i ka ndërmarrë me marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përputhje me komentet e Përgjithshme të autoriteteve kontraktuese dhe me kornizën relevante legjislative.

Identifikimi i palëve të interesuara do të mundësoj që marrëdhëniet ekzistuese të fuqisë të kuptohen më mirë, do të ndihmojë në përcaktimin dhe ndryshimin e dinamikave dhe do të kontribuoj në tejkalimin e dallimeve midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave. Siguroni se do t'i identifikoni palët e interesuara në të gjitha nivelet, duke e përfshirë edhe nivelin e familjes (siç janë fëmijët, prindërit), komunitetit (siç janë liderët fetar, personat me status/autoritet lokal, mësime dhënësit), në nivel lokal (si të punësuar ose si këshilltarë në komunë), në nivel nacional (si ministra, kryeministra) dhe në nivel ndërkombëtar (si ambasadorë, donatorë, organizata ndërkombëtare).

Përveç identifikimit të dy grupeve kryesore, në këtë pjesë duhet të bëhet edhe identifikimi i grupeve me influencë. Bëhet fjalë për grupe të cilat kanë një lloj ndikimi mbi problemin (pozitiv ose negativ) dhe kanë ndikim mbi kapacitetet e poseduesve të të drejtave dhe mbi bartësit e detyrave. Këto grupe më së shpeshti janë joshitetore dhe bëjnë pjesë në sektorin qytetar ose në sektorin e biznesit, religjionet e organizuara, grupacionet ekonomike ose politike dhe në grupet e interesit, medias, donatorëve etj. Këto grupe mund të kenë nivele të ndryshme të ndikimit mbi njërin nga dy grupet kryesore (ose mbi të dy) dhe prandaj me vëmendje të madhe duhet të mbikëqyren dinamikat e fuqisë që rezultojnë nga marrëdhëniet e këtilla.

Analiza e boshllëkut të kapaciteteve

Analiza e boshllëkut të kapaciteteve na ndihmon t'i kuptojmë:

- 1 Mangësitë e bartësve të detyrave për përmbushjen e detyrimeve të tyre,
- 2 Pengesat tek poseduesit e të drejtave për realizimin e të njëjtave, si dhe
- 3 Çka i nevojitet edhe njëherë edhe anës tjetër që të ndërmarrin aktivitete përkatëse në mënyrë që t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e njeriut.

Analiza i përcakton ndërhyrjet e nevojshme në mënyrë që të fuqizohen kapacitetet e poseduesve të të drejtave dhe të avancohet performanca e bartësve të detyrave, ndërkaq realizohet lidhur me 5 dimensionet të cilat na ndihmojnë që t'i kuptojmë shkaqet se pse bartësit e detyrave shpeshherë nuk kanë mundësi t'i përmbushin detyrimet e tyre.

Në kuptimin e gjerë, kapaciteti për implementimin e detyrimeve përmban 5 komponentë/dimensione (adoptuar nga UNCT, 2009):

- 1 **Përgjegjësia/motivimi/përkushtimi/liderizmi** – ka të bëjë me identifikimin individual personal të bartësve të detyrave se diçka duhet të ndërmarr në lidhje me një problem të caktuar. Kjo mund të shihet në pranimin personal të detyrimeve dhe bazohet në parime juridike ose morale.
- 2 **Autoriteti** – ka të bëjë me legjitimitetin e intervenimit të caktuar, përkatësisht kur bartësit e detyrave ndjejnë dhe/ose e dinë se është e mundshme, ose është e lejueshme, të ndërmarrin një aktivitet të caktuar. Çka është, dhe çka nuk është e lejuar

në një shoqëri të caktuar, në masë të madhe determinohet me ligjet, normat dhe aktet formale dhe joformale, traditat dhe kulturën. Megjithatë, elementi moral personal mund të jetë një promotorë progresiv në proceset e realizimit të të drejtave të njeriut.

3 Qasja deri te resurset dhe kontrolli i resurseve – kur bartësi i detyrave do të pranojë se diçka duhet të ndërmerret dhe kur do të ketë mundësi të ndërmerr aktivitet konkret, mungesa e resurseve këtë aktivitet mund ta bëjë të pamundshëm. Së këtejmi, fuqia e veprimit në mënyrë të drejtpërdrejt varet nga resurset që janë në dispozicion. Nga ana tjetër, në përgjithësi ato mund të klasifikohen në tre lloje: resurse njerëzore, ekonomike dhe organizative.

4 Kapaciteti për vendimmarrje racionale dhe për mësim – për vendimmarrje racionale nevojitet vlerësimi i bazuar mbi të dhënat, si dhe analiza logjike e shkaqeve për një problem të caktuar. Aktivitetet duhet të bazohen në vendime të informuara të miratuara përmes analizës. Pas ndërmarrjeve të aktiviteteve, pas vlerësimit të sërishëm të rezultateve dhe të ndikimit do të çojnë në analizë të avancuar dhe në aktivitete më të mira në ciklin e ardhshëm. Ky lloj i procesit learning-by-doing varet shumë nga mundësitë e komunikimit të ekipit konkret dhe të institucionit – këto kapacitete janë kryesore për një proces të avancuar të mësimin të këtillë dhe për diseminimin e njohurive dhe aftësive të fituara përmes strukturave të brendshme të institucionit.

5 Kapaciteti i komunikimit – kapaciteti i komunikimit dhe qasjes në sistemet e informacionit dhe komunikimit është kryesor edhe për bartësit e detyrave edhe për poseduesit e të drejtave në përpjekjet për realizimin e të drejtave të njeriut ose për përmbushjen e detyrimeve. Komunikimi është i rëndësishëm edhe gjatë ndërlidhjes së aktorëve të ndryshëm kryesorë të shoqërisë me rrjetet funksionale të cilat kanë mundësi t'u përgjigjen problemeve të caktuara kritike dhe zhvillimore.

Hapat 2 dhe 3 në mënyrë të thjeshtë janë pasqyruar përmes matricës së roleve dhe kapaciteteve, e cila i përmban poseduesit e identifikuar të të drejtave dhe bartësit e detyrave, të drejtat dhe detyrimet përkatëse, si dhe boshllëkun e kapaciteteve për realizimin e këtyre të drejtave dhe për përmbushjen e detyrimeve.

Shembull për matricën e roleve dhe boshllëku i kapaciteteve

<p>Poseduesit e të drejtave: Fëmijë me aftësi të kufizuara</p>	<p>E drejta: Qasje në arsimin cilësor në bazë të njëjtë me fëmijët pa aftësi të kufizuara</p>	<p>Boshllëku i kapaciteteve: Nevojat: mundësi të kufizuara për fëmijët me aftësi të kufizuara që t'i prezantojnë problemet me të cilat ballafaqohen; mundësi të kufizuara për t'u njohur dhe shoqëruar me fëmijët pa aftësi të kufizuara. Anët e forta: këshilla aktivë të nxënësve</p>
<p>Bartësi i detyrave 1: Administrata në shkollat lokale</p>	<p>Detyrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ sigurimi i qasjes fizike të nxënësve dhe qasja në hapësirat e tjera të shkollës; ■ sigurimi i prezencës së mësuesve, mësimeve dhe/ose të asistentëve personal dhe edukativë; ■ mbajtje e evidencës për performancat e mësuesve, mësimeve dhe/ose të asistentëve personal dhe edukativë. 	<p>Boshllëku i kapaciteteve: Nevojat: kapacitete të vogla për planifikim dhe menaxhment; mundësi të kufizuara për t'i pasur në dispozicion mjetet financiare; kapacitete të ulëta për punë me fëmijë me aftësi të kufizuara të kuadrit mësimor.</p>
<p>Bartësi i detyrave 2: Komunat dhe Qyteti i Shkupit</p>	<p>Detyrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ të siguroj implementim të politikave për arsim inkluziv në nivel lokal; ■ të siguroj mjete për avancimin e qasjes dhe aksesit në procesin e rregullt arsimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara; ■ të ushtroj kontroll mbi shkollat 	<p>Boshllëku i kapaciteteve: Nevojat: mosekzistimi i standardeve të qarta për arsim inkluziv; kapacitete të ulëta për ushtrimin e kontroleve thelbësore në shkolla; buxhete të limituara për arsimin në përgjithësi. Anët e forta: mandat që të ushtroj kontroll mbi shkollat; mandat që të kërkoj nga shkollat që t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas akteve komunale</p>
<p>Bartësi i detyrave 3: Ministria e Arsimit dhe Shkencës</p>	<p>Detyrimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ të krijoj politika për një arsim inkluziv të fëmijëve me aftësi të kufizuara; ■ të ndaj mjete buxhetore për implementimin e politikës, përfshirë këtu edhe për trajnimin e mësuesve, mësimeve dhe të asistentëve personal dhe edukativë. 	<p>Boshllëku i kapaciteteve: Nevojat: mosekzistimi i politikës gjithëpërfshirëse dhe të qartë për një arsim inkluziv; kapacitete të ulëta dhe ekspertizë për zhvillimin e politikës për arsim inkluziv. Anët e forta: fillimi i zhvillimit parcial të politikës për një arsim inkluziv; donatorë aktivë ndërkombëtar për avancimin e arsimit inkluziv</p>

* Të dhënat dhe rezultatet që i fitojmë nga të tre hapat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi krijimin e politikave dhe mbi programimin e aktiviteteve përkatëse. Analiza kauzale kontribuon që problemet dhe sfidat të bëhen më të qarta, ndërsa dy hapat e tjerë i specifikojnë faktorët dhe protagonistët e tjerë të cilët kontribuojnë në gjendjen konkrete. Nga aspekti strategjik Analiza e roleve dhe Analiza e kapaciteteve i

definojnë fushat në të cilat faktorët duhet t'i fuqizojnë kapacitetet, si dhe në atë se në cilin drejtim të zhvillohet Strategjia e partneritetit. Pastaj, këto dy analiza do të kenë ndikim edhe mbi formulimin e autpoteve që do të rezultojnë nga proceset e fuqizimit të kapaciteteve.

Faza 1, hapi 4 – Përcaktimi i prioriteteve dhe qëllimeve

Hapi i fundit i kësaj faze ka të bëjë me vendosjen e prioriteteve të cilat do t'i udhëzojnë politikat dhe programet që do t'i implementojmë. Prioritetet janë si pasojë e drejtpërdrejt e tri hapave paraprak, përmes të cilëve tanimë janë identifikuar problemet dhe sfidat zhvillimore, janë analizuar shkaqet dhe manifestimet e tyre, poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrave, si dhe kapacitetet dhe nevojat e tyre. Disa kritere të caktuara për zgjedhjen e prioriteteve të mundshme mund të jenë:

- diferenca të mëdha midis standardeve për të drejtat e njeriut dhe praktikës në shoqëri;
- komente dhe konkluzione të prezantuara nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me konventat e ratifikuara;
- analiza, komente dhe konkluzione të prezantuara nga institucionet nacionale për të drejtat e njeriut, Ombudsmeni dhe/ose sektori qytetar;
- prioritete nacionale konform standardeve për të drejtat e njeriut dhe Objektivave për zhvillim të qëndrueshëm të OKB;
- tendenca negative shoqërore dhe shkelje të vazhdueshme të të drejtave të caktuara të njeriut etj.

Zgjedhja e partnerëve për arritjen e prioriteteve strategjike

Në vendet në zhvillim ekziston një numër i madh i protagonistëve të cilët e mbështesin agjendën zhvillimore dhe fokusohen në respektimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Përveç institucioneve dhe agjencive shtetërore këta protagonistë, përfshijnë edhe organizata ndërkombëtare, agjencitë e OKB-së dhe organizatat qytetare nacionale, fondacionet dhe donatorë. Në fusha të ndryshme të veprimtimit dhe në zona të ndryshme gjeografike shkalla e mbivendosjes së partnerëve të mundshëm është e ndryshme.

Për zgjedhjen e partnerëve të mirëfilltë, në rastin konkret, duhet të bëhet një analizë e shkurtër e protagonistëve:

- të identifikohen të gjithë protagonistët të cilët janë aktivë në një fushë konkrete;
- të krahasohen programet e tyre të aktiviteteve;
- të qaset në drejtim të partnerëve potencial të nivelit të lartë politikë por edhe të shkëmbehen informacione në nivel operativ, me qëllim që të krijohet korniza optimale për partneritet dhe të shmanget mbivendosja e aktiviteteve;
- të lidhen memorandume për bashkëpunim ose dokumente të ngjashme të cilët do ta përcaktojnë partneritetin;
- të mbahet bashkëpunimi dhe komunikimi me partnerët gjatë periudhës së implementimit të aktiviteteve nga fushëveprimi i përbashkët.

Është shumë thjeshtë të hartohet matrica e partneriteteve e cila do t'i përfshijë të gjithë protagonistët relevantë të cilët janë aktivë në një fushë konkrete. Nëse një pozicion i matricës është përmbledhës (siç janë OQ në shembullin në vijim), atëherë duhet të krijohet matricë e posaçme vetëm për atë pozicion i cili do t'i përfshijë protagonistët

konkret. Natyra e intervenimit strategjik, i cili do të pasojë, do ta përcaktoj edhe zgjedhjen e partnerëve. Sipas rregullit përdorimi i QBDNj në krijimin e politikave dhe programeve do të ketë nevojë për përfshirjen edhe të atyre poseduesve të të drejtave deri te të cilët nuk mund të vihet edhe aq thjeshtë. Kjo do të thotë se numri i partnerëve do të jetë më i madh dhe më përmbajtjesor, për dallim nga qasja e cila nuk është udhëhequr nga të drejtat e njeriut.

Kjo matricë është rezultat i këtij procesi, por mund të plotësohet edhe gjatë implementimit të aktiviteteve me protagonistë të rinj. Nuk duhet të harrojmë se shteti dhe bartësit e tjerë të detyrave e kanë përgjegjësinë për transformimin shoqëror, ndërsa partnerët mundet vetëm të kontribuojnë në këtë drejtim.

Shembull i matricës së partneriteteve					
Arsimi inkluziv i fëmijëve me aftësi të kufizuara	OQ	UNICEF	USAID / US Am.	BE	UNDP
Mobilizimi shoqëror dhe advocacy	x	x			
Zhvillimi i politikave	x	x			
Ndërtimi i kapaciteteve	x		x	x	
Ofrimi i shërbimeve	x				
Ndërgjegjësimi	x	x	x	x	
Paraqitja mediale dhe vizibiliteti	x	x			
Garantimi dhe rigrantimi	x	x	x	x	x

2.2. Faza 2 – Planifikimi dhe dizajni i politikave dhe programeve

Pas përfundimit të analizës së përgjithshme të gjendjes fokusohemi në fazën e planifikimit dhe dizajnit të programit. Planifikimi bazohet në gjetjet, rezultatet dhe prioritetet e përcaktuara me analizën, fazë në të cilën është jashtëzakonisht e rëndësishme vazhdimisht t'i kemi të drejtat e njeriut dhe realizimin e tyre në plan të parë. Për planifikimin dhe dizajnin e suksesshëm të politikave dhe programeve është i domosdoshëm bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve relevante të cilat do të jenë përgjegjëse për realizimin e objektivave të parashtruara dhe rezultateve, duke e pasur parasysh atë se të gjitha implikimet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, në këtë fazë, integrohen në dizajnin në fjalë. Por, akoma më e rëndësishme është se duhet të përfshihen edhe poseduesit e të drejtave, me qëllim:

- të fuqizohet kredibiliteti i politikës dhe/ose programit,
- të ndahet pronësia e politikës në përgjithësi dhe/ose programit midis të gjithë faktorëve, dhe
- të mundësohet përfshirja e të gjitha perspektivave dhe përvojave në procesin e krijimit të politikës në përgjithësi dhe/ose programit, i cili do të krijoj rezultate të qëndrueshme.

QBDNj dhe menaxhmenti i bazuar në rezultate (MBR)

Për këtë qëllim institucionet duhet t'i pranojnë dhe t'i implementojnë parimet e menaxhmentit të bazuar në rezultate. Menaxhmentit i bazuar në rezultate është një

qasje participative dhe ekipore në planifikimin e programeve. Ai e avancon efektivitetin, efikasitetin dhe përgjegjësinë e institucionit dhe paraqet qasje fundamentale në sendërtimin e rezultateve. Institucioni duhet të fokusohet sistematikisht në sendërtimin e rezultateve, me qëllim që t'i siguroj resurset e tij financiare dhe njerëzore të përdoren në mënyrë strategjike në realizimin e ndikimit më të madh të mundshëm. (adoptuar nga UNFPA, 2003, faqe 4 dhe UNESCO, 2007, faqe 6)

Menaxhmenti i bazuar në rezultate na mundëson që ta ndërlidhim atë që e bëjnë me atë që duam ta arrijmë dhe na tregojnë se si ta dimë se kur e kemi arritur. QBDNJ kontribuon në MBR multidimensionale, me atë që i apostrofon çështjet e mirëfillta që duhet t'i parashtrijmë, llojin e ndryshimit drejt të cilit synojmë dhe si ta matim, monitorojmë dhe të raportojmë për ndryshimin e arritur.

MBR i përmban elementët si vijojnë:

- i analizon problemet me qëllim që më mirë t'i kuptoj shkaqet;
- i strukturon politikat dhe programet rreth zinxhirit të rezultateve të bazuara mbi gjetjet e analizës,
- parashikon kauzalitet në zinxhirin e rezultateve,
- përdor indikatorë për matjen e suksesit,
- fokusohet në koston e arritjes së rezultateve, dhe jo në buxhetimin e aktiviteteve,
- bën monitorim, evaluim dhe raportim vis-a-vis rezultateve të planifikuara.

QBDNJ e plotëson MBR me kornizë të përdorshme konceptuale përmes së cilës perceptohen shkaqet e (mos) përmbushjes së të drejtave të njeriut. Në këtë proces QBDNJ i bën vizibil problemet dhe sfidat e kamufluara të cilët e pengojnë zhvillimin. Nga ana tjetër, QBDNJ përcakton se epilogu/ outcome duhet t'i pasqyroj ndryshimet në sjelljen e bartësve të detyrave dhe të poseduesve të të drejtave – përmes performancave të avancuara dhe përgjegjësisve të fuqizuara të të dyja grupeve; se produktet /outputs janë fokusuar në bajpasimin e boshllëqeve të kapaciteteve.

Ilustrim i aspektit komplementar të QBDNJ dhe MBR në arritjen e ndryshimeve

QBDNJ - MBR dhe ndryshimi

← Parimet e të drejtave të njeriut e udhëzojnë procesin →

MBR	QBDNJ	
ndikimi/impact: ndryshimi në...	...Cilësia e jetës (realizimi i të drejtave të njeriut)	Analiza kauzale
↑↓	↑↓	
Epilogu/outcome: ndryshimi në...	... kapacitetet e poseduesve të të drejtave dhe të bartësve të detyrave	Analiza e roleve
↑↓	↑↓	
Produkte/outputs: ndryshimi në...	...kapacitetet e poseduesve të të drejtave dhe të bartësve të detyrave	Analiza e boshllëqeve të kapaciteteve


↑

Burime të identifikimit të sjelljeve të caktuara dhe kapaciteteve:

- konkluzione dhe rekomandime nga UPR, autoritetet kontraktuese;
- Raportet, vërejtjet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e institucioneve nacionale për të drejtat e njeriut dhe Ombudsmanit;
- Raportet, vërejtjet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e OQ nacionale dhe ndërkombëtare aktive në proceset dhe/ose të pranishme në terren

Planifikimi i politikave dhe programeve të bazuara në rezultate ka për qëllim të siguroj që shumica e intervenimeve të mos jetë minimale, por të jetë e mjaftueshme për arritjen e rezultatit të dëshiruar, në rastin tonë për realizimin e të drejtës ose të drejtave të caktuara të njeriut. Ai, veç tjerash, e pasqyron edhe lidhjen kauzale ndërmjet rezultateve të dëshiruara në nivele të ndryshme (produkte/outputs, epilogu/outcome dhe ndikimi/impact). (adoptuar nga UNFPA, 2010, faqe 105).

Nga aspekti i bartësve të detyrave ky lloj i planifikimit të politikave dhe programeve duhet të ketë prioritet, ndërsa shteti duhet të vë në dispozicion mjete për ndërtimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të bartësve të detyrave. Nga ana tjetër, gjatë përpilimit të dokumenteve të ndryshme duhet të përdoret fjalorë dhe terminologji përkatëse. Kjo politikë dhe programet do t'i bëjë precize dhe do ta shmangë konfuzionin eventuale rreth cilësdo qoftë pjesë të tyre. Rekomandohet përdorimi i mekanizmave për të drejtat e njeriut kur zgjidhet fjalori dhe terminologjia. Gjithashtu, do të ishte mirë të përdoren gjuhët të cilat i flasin bashkësitë, në mënyrë që më lehtë të transmetohen mesazhet e vërteta deri te poseduesit e marginalizuar dhe të përjashtuar të të drejtave.



Zinxhiri i rezultateve (result chain) është rrjedhojë kauzale në ndërhyrjet zhvillimore i cili e apastrofon rrjedhojën e nevojshme për arritjen e synimeve të dëshiruara, duke filluar me depozitat, duke lëvizur përmes aktiviteteve dhe produkteve/outputs, dhe duke kulminuar me epilogun /outcome dhe ndikimin /impact. (OECD/DAC, 2002, p. 33)

Këtë zinxhir e përdorim si simplifikim për proceset komplekse ciklike në mënyrë që t'i shohim mënyrat dhe modelet se si resurset dhe aktivitetet do të kontribuojnë në arritjen e rezultateve të parashikuara, dhe në këtë mënyrë t'i realizojmë ndryshimet e dëshiruara zhvillimore.

Depozitime/Input janë resurset financiare, njerëzore dhe materiale që janë përfshirë në intervenimet zhvillimore. (OECD/DAC, 2002, p 25) Në përputhje me QBDNj, është jashtëzakonisht e rëndësishme këto resurse të jenë të mjaftueshme dhe adekuate, në mënyrë që të arrijnë deri te komunitetet më të marginalizuara dhe më të përjashtuara. Mënyra se si do të përcaktohen varet nga rasti në rast, megjithatë duhet të merret parasysh se një gjë e këtillë duhet të bëhet duke i pasur parasysh synimet që duam t'i arrijmë dhe jo vetëm nevojat e aktiviteteve.

Aktivitete janë veprimet e ndërmarra ose punët e kryera përmes të cilave mobilizohen inputet e ndryshme, siç janë fondet, mbështetja teknike dhe resurset e tjera, të cilat janë fokusuar mbi realizimin e produkteve /outputs të caktuara. (OECD/DAC, 2002, p. 15)

Dizajnin e aktiviteteve doemos duhet ta ketë QBDNj si metodë udhëzuese, meqë nga implementimi i të njëjtave në terren më së shumti do të varet realizimi i produkteve /

outputs dhe epilogut /outcome. Nga ana tjetër, ato në mënyrë të drejtpërdrejt do të ndikojnë mbi impaktin që do ta ketë politika ose programi zhvillimor. Në përgjithësi, aktivitetet duhet të kontribuojnë në mënyrë përkatëse në promovimin e të drejtave të njeriut; të jenë kompatibil me aktivitetet e faktorëve të tjerë, me qëllim të shmangies së mbivendosjes, kundërthënive dhe dërgimit të mesazheve të gabueshme; të fokusohen në adresimin e shkaqeve esenciale; si dhe të sigurojnë pjesëmarrje të poseduesve relevantë të të drejtave dhe të bartësve të detyrave.

Aktivitetet ndodhin në terren dhe nëse të njëjtat dizajnohen dhe planifikohen në bazë të të drejtave të njeriut, ato do t'i përfshijnë të gjithë faktorët e interesuar, nga të cilët më të rëndësishëm janë poseduesit e marginalizuar dhe të përjashtuar të të drejtave.

Produkte/Outputs janë produktet ose shërbimet si rezultat i aktiviteteve të implementuara. Ato duhet të jenë të prekshme, të realizueshme dhe të mjaftueshme për realizimin e epilogut/outcome të dëshiruar të politikave ose programeve të cilat i krijojnë bartësit e detyrave. (adoptuar nga UNDG, 2007)

Produkti/output i bazuar në të drejtat e njeriut është produkti ose shërbimi i cili është dizajnuar të kontribuoj në reduktimin e boshllëqeve në kapacitetet e:

- 1 Poseduesve të të drejtave që t'i gëzojnë dhe realizojnë të drejtat e tyre dhe/ose bartësve të detyrave që t'i përmbushin detyrimet përkatëse; dhe
- 2 Kornizave juridike, institucionale të politikave që të krijojnë mjedis përkatës për poseduesit e të drejtave ndërsa bartësit e detyrave t'i realizojnë rolet e tyre. (UNFPA, 2010, faqe 105)

Epilogu/Outcome është efekti i mundshëm ose efekti i realizuar afatshkurtër dhe afatmesëm, i shkaktuar përmes produkteve /outputs (OECD/DAC, 2002, p. 28). Për realizimin e tyre zakonisht nevojitet angazhim kolektiv nga partnerët. Ato paraqesin ndryshime në kushtet zhvillimore të cilat ndodhin pas realizimit të produkteve /outputs, ndërsa para arritjes së ndikimit /impact të dëshiruar.

Nga aspekti i QBDNj, nëse me sukses plotësohen boshllëqet e kapaciteteve, nëse arrihet outcome atëherë performancat e poseduesve të të drejtave dhe të bartësve të detyrave do të avancohen.

Ndikimi/Impact është efekt afatgjatë pozitiv ose negativ, efekt afatgjatë primar ose sekondar i gjeneruar nga ndërhyrja e caktuar zhvillimore, në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë, të dëshiruar ose të padëshiruar. (OECD/DAC, 2002, p. 24)

Nga prizmi i QBDNj kjo nënkupton se një e drejtë e caktuar është realizuar ose është arritur një qëllim i caktuar zhvillimor.

2.3. Faza 3 – Implementimi

Faza e ardhshme është faza e veprimit. Këtu çdo gjë që është planifikuar në fazën paraprake vihet në lëvizje. Sa më mirë që do të kryhet faza "Planifikimi dhe dizajni i politikave dhe programeve" - aq më lehtë do të rrjedhë kjo fazë.

Implementimi i politikave dhe programeve të udhëzuara nga QBDNj ka tre karakteristika kryesore:

- 1 Standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut janë udhëzues në këtë fazë dhe kërkojnë përfshirje të thellë në implementimin, nëse duam t'i arrijmë rezultatet e dëshiruara dhe të kemi impakt në afat të gjatë. Kjo nënkupton se duhet me kujdes t'i monitorojmë elementët dhe hapat e parashikuar në fazën paraprake.

2 Gjatë implementimit në mënyrë thelbësore dhe të plotë përfshihen bartësit e detyrave dhe poseduesit e të drejtave. Për politika dhe programe të suksesshme dhe efçente nacionale duhet të përfshihen një numër i madh i protagonistëve gjatë negociatave të ndryshme. QBDNJ kërkon qasje ndër-resoriale dhe ndër-sektoriale dhe përfshirjen e të gjithë faktorëve relevantë.

3 Mënyra e implementimit dhe qasja strategjike në të njëjtën janë fokusuar në inkurajimin e poseduesve të të drejtave dhe në ndërtimin e kapaciteteve të bartësve të detyrave, me qëllim që të përmbushen detyrimet ndaj poseduesve të të drejtave.

Kjo do të thotë se në këtë fazë duhet të bashkëpunohet me një numër të madh të faktorëve – posedues të të drejtave, me përfaqësuesit e tyre (më së shpeshti organizata qytetare) dhe me bartësit e detyrave. Kjo vetvetiu është një sfidë, por kjo sfidë do të jetë akoma më e madhe kur do të bashkëpunohet me faktorët të cilët kanë njohuri më të mëdha për të drejtat e njeriut, me mosrespektimin e tyre dhe kufizimin në terren, si dhe sa i përket implementimit të QBDNJ. Duhet ta keni parasysh atë se të gjithë janë në anën e njëjtë dhe se në këtë proces keni qëllime të njëjta, si prizmat përmes të cilave i mbikëqyrni problemet, ndërsa sfidat janë të ndryshme. Respektoni të gjithë ata që janë përfshirë në procesin e implementimit dhe duhet të jeni të hapur që të mësoni nga ata që kanë njohuri më të mëdha. Nëse në mesin e partnerëve keni udhëheqës fetar ose udhëheqës të tjerë nga komunitetet, përfshini edhe ata në mënyrë esenciale në procesin e implementimit – në këtë mënyrë do të mund të arrini edhe deri te grupet, komunitetet dhe / ose njerëzit e marginalizuar dhe të përjashtuar. Përfundimisht, siguroni pronësi të ndarë për implementimin dhe rezultatet e arritura. Në këtë mënyrë do të kontribuoni në zgjidhje më të qëndrueshme afatgjata.

2.4. Faza 4 – Monitorimi dhe evaluimi (M&E)

Faza e monitorimit dhe evaluimit ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rezultateve të arritura vis-a-vis atyre që i planifikuam dhe presim se a do ta arrijnë impaktin e parashikuar. Monitorimi dhe evaluimi janë dedikuar që ta specifikojnë procesin e miratimit të vendimeve, si për shembull, a të vazhdohet me intervenimin, në cilën mënyrë të avancohet i njëjti, a thua struktura e cila e implementon politikën ose programin në fjalë është e mjaftueshme ose duhet të zgjerohet/riorganizohet etj.

Mënyrat se si do të kryhet M&E të një politike ose programi parashikohen që në fazën e planifikimit dhe dizajnit të politikave dhe programeve. Më së shpeshti ato përfshihen në dokumentin (Planin, Strategjinë, Sistemin etj.) i cili në mënyrë narrative i përmban mënyrat e parashikuara sipas të cilave do të bëhet M&E, i cili shoqërohet nga Matrica M&E. Ajo i përfshin elementët kryesorë të pjesës narrative. Matrica ndihmon që ta arrijmë perspektivën e zogut në proceset e M&E dhe në mënyrë më të lehtë të koordinohen të njëjtit.

Elementi kyç në këtë fazë, nga aspekti i implementimit të QBDNJ konsiston me atë se medoemos duhet të sigurojmë monitorim dhe evaluim të proceseve, krahas M&E të epilogut/output dhe ndikimit /impact.

QBDNJ kryesisht fokusohet mbi proceset, meqë në këtë mënyrë e siguron përfshirjen e njerëzve dhe grupeve më të marginalizuara në programe dhe e siguron kontributin e tyre në avancimin e gjendjeve dhe proceseve që janë fokusuar ndaj tyre. Së këtëjmi, QBDNJ do të ketë cilësi më të madhe të rezultateve, si dhe qëndrueshmëri afatgjatë të tyre. QBDNJ parashikon M&E për proceset nga aspekti i realizimit të të drejtave të njeriut për poseduesit e të drejtave dhe prandaj fokusohet në mbikëqyrjen e: (UNICEF Finlandë, 2015, faqe 30):

- 1** Pjesëmarrjes dhe empowerment të poseduesve të të drejtave,
- 2** Përgjegjësisë së bartësve të detyrave, dhe
- 3** Ndryshimeve në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Monitorimi i proceseve

QBDNj parashikon se asnjë politikë ose program nuk duhet t'i dëmtoj të drejtat e njeriut edhe atë në asnjëfarë mënyrë. Prandaj, duhet të mbikëqyrjet me kujdes dhe të vlerësohet nëse intervenimet, edhe pse disa të drejta shënojnë progres, nuk ndikojnë në mënyrë negative mbi gëzimin e të drejtave të tjera. Nëse kjo është kështu, dokumenti M&E parashikon edhe mënyra sipas të cilave do të hulumtohet dhe do të anulohet dëmi i shkaktuar. Nga ana tjetër, QBDNj kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të strukturuar dhe vlerësim të parimeve të të drejtave të njeriut dhe implementim të tyre, si pjesë integrale.

Mbikëqyrja jo vetëm që duhet të bëhet në mënyrë të rregullt, por gjithashtu duhet të përfshijë edhe mekanizma të vendosur me dokumentin M&E përmes të cilëve do të sigurohet pjesëmarrje esenciale dhe e plotë e faktorëve të tjerë në këtë proces, si dhe sens për vërejtjet, ankesat, komentet dhe kërkesat e tyre.

Çdo politikë ose program i suksesshëm të cilin e implementon QBDNj, ndikon mbi marrëdhëniet e fuqisë midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave. Kjo nënkupton se duhet të priten tensione në ciklin e përgjithshëm të implementimit. Këto tensione duhet të monitorohen që të evitohen konflikte të natyrave të ndryshme të cilët mund të shndërrohen edhe në dhunë. Një qasje e krijuar mirë në drejtim të monitorimit dhe zbutjes së konflikteve potenciale është e domosdoshme në fazën e planifikimit të dokumentit M&E.

Evaluimi i rezultateve

Qëllimi i politikave dhe programeve të cilat e njohin QBDNj është shkaktimi i ndryshimit pozitiv dhe avancimi i jetës së njerëzve. Pikërisht ky dimension merret si rezultat i matshëm në fazën e planifikimit dhe dizajnit të politikave dhe programeve, por edhe si rezultat i cili do t'i nënshtrohet vlerësimi në këtë fazë.

QBDNj në vetvete i inkorporon njerëzit dhe grupet e marginalizuara dhe përjashtuara, si posedues esenciale të të drejtave dhe i përfshin në të gjitha fazat e ardhshme. Kjo nënkupton se edhe ndryshimi, i cili duhet të matet doemos duhet t'i përfshijë edhe ato, përkatësisht të vlerësohet nëse ndryshimet janë të dukshme edhe në përditshmërinë e tyre, për dallim nga indikatorët sipas të cilëve monitorohet implementimi i politikave dhe programeve nacionale që nuk janë konform QBDNj. Në të vërtetë, kjo nënkupton sigurim të të dhënave plotësisht të disagreguara edhe atë në më shumë baza, të cilat duhet të grumbullohen dhe të përdoren në fazën 2, 3 dhe 4. Kritere të mundshme për disagregimin e të dhënave janë: aftësitë e kufizuara, gjinia, seksi, orientimi seksual, përkatësia etnike, feja, grupi i marginalizuar, dallimet pasurore, dallimi midis kushteve urbane dhe rurale, përkatësia në një grup të caktuar, mosha etj.

Njëra nga mënyrat e vizualizimit të dimensioneve në të cilat dëshirojmë të arrijmë ndryshim, varësisht nga intervenimi konkret, është përmes vlerësimit të ndryshimeve të cilat dëshirojmë të ndodhin në fusha të caktuara (Joachim Theis, 2003):

- * **Ndryshime në politikat dhe praktikat:** në këtë rast vlerësohet se a është përforcuar përgjegjësia tek bartësit e detyrave duke iu përgjigjur pyetjeve si vijon:
- * A janë ndryshuar ose miratuar politika, ligje dhe programe të reja?
- * A është më eficient implementimi i politikave, ligjeve dhe programeve ekzistuese në drejtim të parandalimit të shkeljes së të drejtave të njeriut?
- * A ka ndryshime në ndërgjegjësimin, sjelljet, praktikat, normat dhe vlerat?
- * A është rritur alokimi i mjeteve buxhetore të dedikuara për njerëzit e varfër, njerëzit e marginalizuar dhe për njerëzit në rrezik?

- * **Ndryshime në drejtësi, inkluzion dhe mosdiskriminim:** Çdo njeri i posedon të drejtat e njëjta të njeriut në çdo vend dhe në çdo kohë. Mosdiskriminimi dhe barazia janë parimet kyç të të drejtave të njeriut dhe të QBDNj. Një pjesë e pyetjeve të cilat kërkojnë përgjigje që të monitorohen ndryshimet në këtë dimension janë:
 - A janë sfiduar/ndryshuar normat dhe praktikat ekzistuese diskriminuese?
 - A është rritur ndërgjegjësimi dhe a janë ndryshuar qëndrimet diskriminuese?
 - A është rritur alokimi buxhetor për adresimin e ardhshëm të padrejtësisë, ekskluzionit dhe diskriminimit?
 - A janë përforcuar në mënyrë esenciale kapacitetet e bartësve të detyrave që t'i përfshijnë grupet e marginalizuara?
 - A janë rritur kapacitetet e poseduesve të të drejtave që t'i kërkojnë të drejtat e tyre?
 - A arrin politika/programi deri te të gjithë?
- * **Ndryshime në participimin e poseduesve të të drejtave:** kur njerëzit mund të ndikojnë mbi mënyrat dhe esencën e vendimeve të miratuara, përgjegjësia e bartësve të detyrave fuqizohet. Disa pyetje për vlerësimin e nivelit të ndryshimeve në këtë dimension:
 - * A mundet grupi i synuar t'i realizoj të drejtat e veta?
 - * A kanë mbështetje kur duan t'i realizojnë?
 - * A ekziston hapësirë e mjaftueshme e cila mundëson participim të plotë të të gjithë poseduesve të interesuar të të drejtave?
 - * A mundet poseduesit e të drejtave në mënyrë esenciale të marrin pjesë në proceset, veçanërisht në ato të cilët janë fokusuar mbi ta?
- * **Ndryshime në kapacitetet e OQ në mënyrë që ta mbështesin realizimin e të drejtave të njeriut:**
 - A kanë OQ më shumë konstituentë të cilët iu drejtohen për shkeljet e të drejtave të njeriut?
 - A kanë rrjetet e OQ cilësi të re dhe dimension të ri në punën e OQ-ve?
 - A thua OQ dhe rrjetet ndikojnë fuqishëm mbi respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbi implementimin e QBDNj?
 - A mobilizojnë rrjetet e OQ-ve forca dhe resurse më të mëdha për ndryshime pozitive në realizimin e të drejtave të njeriut?

3. QBDNJ DHE BUXHETIMI I BAZUAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Buxheti i një shteti është dokumenti më i rëndësishëm ekonomik i tij dhe ka rol qendror në mbështetjen e realizimit të të drejtave të njeriut. Krijimi i buxheteve, bazuar mbi të drejtat e njeriut, është komponenti kyç i QBDNj, meqë realizimi i të gjitha të drejtave të njeriut ka nevojë për mjete. Esenca e procesit të krijimit të buxheteve, konform QBDNj, konsiston me atë që t'i ndërlidhë resurset e nevojshme për realizimin dhe/ose avancimin në një nivel të caktuar, me vet të drejtën. Për shembull, sistemi funksional gjyqësor është i domosdoshëm për realizimin e të drejtës së qasjes deri te drejtësia; ose realizimi i të drejtës së arsimit nënkupton objekte të ndërtuara dhe të sigurta, klasë të pajisura, trajnime të vazhdueshme të mësimitdhënësve dhe të kuadrit tjetër.

Këto marrëdhënie të drejtpërdrejta dhe të afërta midis buxheteve shtetërorë dhe realizimi i të drejtave të njeriut gjithnjë e më shumë identifikohen nga organizatat ndërkombëtare, veçanërisht nga OKB, ndërsa zyrat në terren të OHCHR punojnë aktivisht në këtë fushë me qeveritë dhe OQ-të. Nëse autoritetet duan t'i përdorin buxhetet që në mënyrë efektive t'i realizojnë të drejtat e njeriut të qytetarëve të tyre, ata doemos duhet ta kuptojnë raportin midis buxhetit dhe detyrimeve të ndërmarra me marrëveshjet ndërkombëtare. (OHCHR, 2017)

Buxhetimi i bazuar mbi rezultatet nënkupton zhvillim të mekanizmave të cilët do të mundësojnë:

- Monitorim të alokimeve buxhetore dhe shpenzimeve buxhetore;
- Krijim të sistemit M&E me rezultate dhe resurse qartësisht të ndërlidhura dhe të preferuara;
- Analizë të rezultateve dhe implementim të këtyre gjetjeve në vet procesin e alokimit të mjeteve;
- Strukturë stimuluese e cila do të motivoj të arrihen rezultate më të mira.

Në Raportin e OKB-së të ish-raportueses speciale për varfëri ekstreme dhe për të drejtat e njeriut Magdalena Sepulveda Karmona, edhe pse në kontekste të kufizuara, e specifikon bazën e mënyrës se si shtetet dhe bartësit e detyrave t'i kuptojnë buxhetet shtetërorë: "Participimi, përgjegjësia, transparenca dhe qasja deri në informacionet janë parime kritike të të drejtave të njeriut, të cilët nga ana tjetër, zbatohen në politikat fiskale nëpër ciklet e politikave, duke filluar nga dizajnimi i buxhetit dhe tatimeve, përmes alokimit të shpenzimeve, deri te monitorimi dhe evaluimi i ndikimit. (M. S. Karmona, 2014, faqe 7)

Pastaj, ajo e jep sqarimin lidhur me atë se çka nënkuptohet me participim, me përfshirjen efektive dhe të konsiderueshme të organizatave të shoqërisë civile, por edhe të atyre mbi të cilët "këto politika do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejt duke i përfshirë personat që jetojnë në varfëri". (M. S. Karmon, 2014, faqe 8)

QBDNJ gjatë buxhetimit bazohet në disa detyrime të cilat kjo qasje ua "imponon" shteteve. Këto detyrime të aspektit financiar, kryesisht burojnë nga korpusi i të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, përkatësisht nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Detyrimi për realizimin progresiv të të drejtave

Për të drejta të caktuara shteti është i obliguar në mënyrë progresive ta realizoj gëzimin e tyre të plotë nga poseduesit e të drejtave. Në këtë grup bëjnë pjesë një numër i madh i të drejtave të mbrojtura me Paktin Ndërkombëtar për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore – e drejta për të ardhura përkatëse, e drejta për kujdes shëndetësor, arsim, strehim etj. Për realizimin e të gjitha të drejtave të njeriut duhet të akordohen mjete financiare të cilat janë të domosdoshme, përkatëse dhe të mjaftueshme.

Nga aspekti i buxhetimit, realizimi progresiv mund të ketë shumë forma – fonde të drejtpërdrejta, zbatim të resurseve të tjera dhe të programeve të tjera, reduktim të kufizimeve, ndryshim të politikave me qëllim të përforcimit të të drejtave të grupeve të marginalizuara etj. Marrë në përgjithësi, realizimi progresiv gjatë buxhetimit ndodh kur një shtet i caktuar ndërmer hapa të cilët synojnë t'i avancojnë rezultatet e arritura. Realizimi progresiv duhet të ekzistoj gjatë gjithë kohës dhe nuk varet nga rritja ekonomike, por nënkupton përdorim efektiv të resurseve ekzistuese në dispozicion. Barra e provës bie mbi shtetin që të dëshmojë se të gjitha impenjimet e mundshme janë ndërmarrë që të realizohet progresi i të drejtave konkrete, në kuadër të resurseve në dispozicion. (FLAC Brifing, 2014, faqe 2)

Detyrimi për realizimin urgjent të të drejtave

Disa të drejta të caktuara shtetet medoemos duhet t'i përmbushin menjëherë dhe urgjentisht, pavarësisht mjeteve në dispozicion. Disa të drejta të caktuara njëherësh janë të aplikueshme për të gjithë njerëzit dhe në çdo kohë. Të këtilla janë e drejta e barazisë dhe ndalimi i diskriminimit, të cilat duhet të respektohen, mbrohen dhe realizohen urgjentisht nga ana e shteteve. Për shembull, kjo nënkupton pagë të njëjtë për punë të njëjtë të burrave dhe grave.

Mbrojtja e minimumit të nivelit të nevojshëm të të drejtave të njeriut

Shteti ka detyrim ta siguroj dhe mbroj minimumin e nivelit të nevojshëm të gëzimit të të drejtave të njeriut, ndërsa me këtë ta siguroj të drejtën e standardit adekuat jetësor, i cili nga ana tjetër, pasqyrohet në të gjitha fushat e jetës së poseduesve të të drejtave, ndërsa fillimisht në përgjigjen e pyetjes se a kanë poseduesit jetë dinjitoze.

Minimumi i nivelit të nevojshëm të detyrimeve të shtetit, si pasqyrë e minimumit të nivelit të nevojshëm të të drejtave, në çdo shtet është i ndryshëm. Shprehja "minimumi i nivelit të nevojshëm" është vetëm linja e përcaktuar bazë nën të cilën nuk mund të ketë realizimin të të drejtave. Synohet që shteti vazhdimisht ta avancoj këtë nivel, si dhe ta avancoj gëzimin e të drejtave të poseduesve, në të gjitha fushat

Shteti (palë e PNDESK) në të cilin një numër i konsiderueshëm i personave janë privuar nga artikujt kryesorë ushqimorë, nga mbrojtja e nevojshme primare shëndetësore, strehimi bazik, ose nga format themelore të arsimit, prima facie, është shtet i cili nuk i përmbush detyrimet e veta, në përputhje me Paktin. (Komiteti për ESKP, 1990)

Vlerësimi i të drejtave (3AQ)

Pyetjes të cilës duhet t'i përgjigjen krijuesit e buxheteve dhe të politikave buxhetore gjatë realizimit të çdo të drejte veç e veç, është "a janë të mjaftueshme mjetet e shpërndara që të kënaqen standardet minimale adekuate, aksesit financiar, aksesit dhe cilësia për realizimin e të drejtave."

Nga aspekti i buxhetit shtetëror, vlerësimi për realizimin e të drejtave pasqyrohet përmes formulës 3AQ e cila është shpjeguar më lartë, me dy përshtatje të natyrës financiare.

Nocioni "**adekuat**"/"**adequate**" e konkretizon nocionin "pranueshmëri"/"acceptable" nga aspekti buxhetor. Kjo nënkupton se buxhetet duhet të dizajnohen në mënyrë përkatëse që t'u përgjigjen nevojave të të drejtave të njeriut në terren.

Nocioni "**qasja financiare**"/"**affordable**" e konkretizon nocionin "qasje"/"available" dhe nënkupton se buxhetet dizajnohen në mënyrë që poseduesve të të drejtave, të cilët kanë të ardhura më të ulëta në shoqëri, ose të cilët janë të varur nga shteti, iu mundësohet ta realizojnë të drejtën e tyre.

Një e drejtë e caktuar është "**aksesi**"/"**accessible**" nëse poseduesve të të drejtave nuk iu shkurtohet gëzimi i kësaj të drejte, si dhe në rastet kur shteti në mënyrë aktive e mbështet të njëjtën. Pohimi se një e drejtë e caktuar është e aksesshme mund të shihet përmes përgjigjes në pyetjen nëse shtetet mundësojnë stimulime financiare, programe të përpunuara financiare dhe ngjashëm, me qëllim që të gjithë poseduesit e të drejtave të kenë akses të njëjtë deri te një e drejtë e caktuar.

"**Cilësia**"/"**quality**" është pyetje e fundit buxhetore të cilës duhet t'i përgjigjemi gjatë krijimit të buxhetit – a sigurojmë përmes alocimit të mjeteve, të cilat mundësojnë realizim përkatës, të aksesshëm dhe realizim financiarisht të qasshëm të ndonjë të drejte, edhe rritje esenciale të cilësisë së gëzimit të së drejtës. Nga aspekti i QBDNJ, kjo nënkupton

cilësi të njëjtë të të drejtës për të gjithë poseduesit e të drejtave. Nga ana tjetër, nëse bëhet fjalë për shërbime të cilat e mbështesin realizimin e ndonjë të drejte të caktuar, kërkesa e cilësisë nënkupton se ato të drejta duhet të standardizohen në një nivel të caktuar dhe në nivelin e njëjtë t'ju mundësohen të gjithë poseduesve të të drejtave.

Shteti e ka për detyrë t'i përdorë financat publike në mënyrë sa më efikase, me qëllim të benefitit maksimal të shoqërisë. (Parimet e Limburgut për implementimin e PNDESK, neni 23)

Detyrimi për përdorimin e maksimumit të resurseve në dispozicion

Ky detyrim nënkupton se autoritetet dhe bartësit e detyrave duhet ta japin maksimumin nga vetvetja që të mobilizohen resurse të cilat pastaj do t'i përdorin për avancimin e të drejtave të njeriut. Në rastet kur resurset nacionale janë të pamjaftueshme, shteti doemos duhet të siguroj mbështetje ndërkombëtare dhe resurse për realizimin e të njëjtave. Sidoqoftë, shteti duhet ta jap maksimumin e vet që t'i mobilizoj të gjitha resurset që i ka në dispozicion, pavarësisht se a janë nacionale ose ndërkombëtare.

Ky detyrim përfshin edhe disa elementë të tjerë:

- Shtetet doemos duhet t'i japin prioritet përdorimit të resurseve buxhetore për avancimin e gëzimit të të drejtave të njeriut. Mjetet të cilat tanimë janë dedikuar për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut nuk duhet të rishpërndahen në fusha tjera dhe duhet plotësisht të shpenzohen për dedikimet fillestare.
- Grumbullimi dhe shpenzimi i mjeteve buxhetore duhet të jetë efikas dhe efiçentë.
- Parandalimi i korrupsionit është primar – në këtë mënyrë parandalohet rrjedhja e mjeteve financiare dhe regresi i gëzimit të të drejtave të njeriut.

Detyrimi për mosndërmarrje të masave retrograde

Rrjedha logjike e Detyrimit për realizimin progresiv të të drejtave konsiston me atë se masat retrograde janë jokompatible ndërsa shteti e ka për detyrë të përmbahet nga ndërmarrja e qëllimshme e të njëjtave. Shteti nuk mund ta anulojë progresin e arritur në gëzimin e të drejtave të njeriut, përveç në kushte jashtëzakonisht të kufizuara. Madje edhe në këto kushte të kufizuara shteti do të duhet të ofroj justifikime serioze se (OHCHR, 2017):

- ka ndërmarrë të gjitha përpjekjet dhe i ka përdorur të gjitha resurset në dispozicion;
- i ka ndërmarrë të gjitha përpjekjet e mundshme në mënyrë që t'i kënaq detyrimet minimale;
- gjatë miratimit të vendimit vëmendje të posaçme u ka përkushtuar grupeve vulnerabile; si dhe
- kur shkaqet për masa restriktive do të pushojnë, të njëjtat menjëherë do të tërhiqen ndërsa efektet negative që i kanë lënë midis poseduesve të të drejtave, do të anulohen menjëherë.

Ana tjetër e këtij detyrimi është se shtetet duhet të shqyrtojnë alternativa të ndryshme për grumbullimin e mjeteve financiare, para se t'i ndërpresin mjetet, në mënyrë me të cilën do të ndikoj drejtpërdrejt në gëzimin e të drejtave të njeriut.

Vlerësimi i ndikimit

Shtetet periodikisht duhet ta bëjnë vlerësimin e ndikimit të cilin shpërndarjet buxhetore e kanë përfshirë në realizimin e të drejtave të njeriut. Këto procese është më se e nevojshme

të jenë transparente dhe participative, ndërsa publiku i gjerë duhet të ketë këqyrje në financat dhe në efektet e shpërndarjes së tyre, të ketë këqyrje në analizat e ndryshme të shtetit dhe entiteteve joshitetore që kanë të bëjnë me mjetet buxhetore dhe me efektet e tyre në terren, por edhe të ushtrij mbikëqyrje mbi proceset e përdorimit të mjeteve financiare (edhe gjatë vlerësimit të ndikimit, por edhe gjatë kohëzgjatjes së politikave të caktuara).

Vlerësimi i ndikimit, nëse bëhet në mënyrë përkatëse, do të siguroj këqyrje esenciale në të gjitha aspektet e shpenzimit të mjeteve buxhetore, si dhe në ndikimin e drejtpërdrejt të realizuar në terren. Me përfshirjen edhe të efekteve reale nga politikat në këtë analizë, do të kemi edhe një pasqyrë komparative të mjeteve, vis-à-vis të drejtave, ndërsa madje edhe do ta kuantifikojmë koston e ndonjë të drejte të caktuar individuale në nivel lokal, nacional ose në ndonjë nivel tjetër. Këto të dhëna do të kenë rëndësi të madhe në ciklin e ardhshëm të krijimit të politikave dhe mjeteve buxhetore për mbështetjen e tyre.

4. INDIKATORËT E MONITORIMIT

Zhvillimi i indikatorëve përkatës për monitorimin e realizimit të të drejtës konkrete të njeriut është hapi kryesor gjatë dizajnit të politikës ose programit të caktuar. Nga aspekti i fazave të trajtuara më lartë, indikatorët zhvillohen në fazën e dytë, në kohën e planifikimit dhe dizajnit të politikave dhe programeve. Megjithatë monitorimi i tyre zhvillohet në vazhdimësi, nëpër fazat e implementimit dhe M&E.

Ideja e zhvillimit të indikatorëve për realizimin e të drejtave të njeriut buron nga mendimi se nëse diçka nuk mund të matet/numërohet, atëherë do të mbetet e pavërejtur dhe/ose e pakryer. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për të drejtat e njeriut, meqë ato janë narrative, të bazuara mbi vlera të inkorporuara në narracionin juridik dhe për nga natyra janë plotësisht të pamatshme. Prandaj të njëjtat duhet të transformohen në kontekstin e kuptueshëm dhe të prekshëm, të kenë mesazh të theksuar dhe të qartë dhe të jenë të operacionalizuara. Përmes identifikimit dhe përdorimit të indikatorëve kualitativë dhe kuantitativë ne e sqarojmë përmbajtjen e standardeve, normave dhe parimeve të të drejtave të njeriut.

Qëllimi i indikatorëve është përmes tyre t'i menaxhojmë proceset e ndryshimeve dhe të realizimit të të drejtave të njeriut. Përmes indikatorëve përkatës ne mund ta masim se sa i kemi arritur rezultatet e dëshiruara, me politikën konkrete, si dhe t'i artikulojmë ndërlidhjet midis qëllimeve, politikave, aktiviteteve dhe të drejtave.

Indikatorë për të drejtat e njeriut është informacioni në fjalë për gjendjen në të cilën është ndonjë ngjarje, aktivitet, epilog ose qëllim (OHCHR, 2012, faqe 16):

- kush mund të lidhet me standardet dhe normat për të drejtat e njeriut;
- kush i adreson ose i pasqyron parimet e të drejtave të njeriut ose shkeljet e tyre; dhe
- kush mund të përdoret si vlerësim dhe monitorim të promovimit dhe implementimit të ndonjë të drejte të caktuar.

4.1. Llojet e indikatorëve për matjen e realizimit të të drejtave të njeriut

Kualitativ dhe kuantitativ

Indikatorët kuantitativ janë indikatorë të shprehur në numra (absolut, në përqindje...) dhe kanë formë statistikore, ndërsa indikatorët kualitativ janë indikatorë përshkrues dhe narrativ dhe kanë për qëllim t'i pasqyrojnë të dhënat që ndodhen në sfondin e statistikës së pastër dhe duan të pasqyrojnë një ndryshim të caktuar kualitativ në terren, në gjendje të caktuar ose në realizimin e një të drejte të caktuar.

Të bazuara në fakte (objektive) dhe të bazuara në qëndrime (subjektive)

Faktet dhe ngjarjet të cilat mund të pasqyrohen në mënyrë të drejtpërdrejt dhe të verifikohen janë objektive, ndërsa ato të cilat bazohen në perceptimin, mendimin ose vlerësimin e individëve – janë subjektive.

Indikatorë të performancave dhe indikatorë të harmonizimit

Indikatorët e performancave e kanë për qëllim kryesor ta mundësojnë verifikimin e ndryshimeve të arritura, vis-à-vis asaj që është planifikuar; përdoren në monitorimin e performancave të aktiviteteve programore, konform normave dhe standardeve të të drejtave të njeriut. Indikatorët e harmonizimit në mënyrë eksplicite ndërlidhen me standardet për të drejtat e njeriut dhe kanë për qëllim ta tregojnë vëllimin e harmonizimit të detyrimeve të cilat burojnë nga standardet me realizimin e avancuar të të drejtave të njeriut.

Indikatorë dhe kriteri

Kriteri (benchmark) është vlerë e parapërcaktuar e një indikatorë konkret i cili e pasqyron numrin ose përqindjen absolute konkrete që duam ta arrijmë përmes politikës ose programit.

4.2. Matja e realizimit të të drejtave të njeriut

Siç u shpjegua më lartë, QBDNJ është qasje e cila me rëndësi të njëjtë i përfshin qëllimet dhe proceset. Kjo më së miri mund të shihet në zhvillimin e indikatorëve dhe në popullatën e tyre, meqë QBDNJ e imponon monitorimin e sendërtimit të proceseve dhe rezultateve.

Indikatorët që do t'i zhvillojnë, në të vërtetë e matin nivelin e pranimit të detyrimeve të cilat rezultojnë nga instrumenti ndërkombëtar në fjalë, si dhe nivelin e realizimit të tyre në shtet. Ky është një proces i trefishtë i cili e mat nivelin e pranimit të detyrimeve, përpjekjeve që duhet t'i ndërmerr shteti që t'i përmbush detyrimet në fjalë, si dhe rezultatet e përpjekjeve përmes prizmit të realizimit të avancuar të të drejtave të njeriut.

Rrjedhimisht, indikatorët që duhet ta mbështesin procesin e dizajnit dhe implementimit të politikave dhe programeve dizajnohen nga shteti në tri nivele:

- Indikatorë strukturorë,
- Indikatorë procesual, dhe
- Indikatorë të epilogut /outcome.

Indikatorët strukturorë

Pas ratifikimit të instrumentit të caktuar ndërkombëtar paraqitet nevoja për përpilimin e vlerësimit të përkushtimit të shtetit në implementimin e detyrimeve të cilat i ka marrë. Indikatorët strukturorë e mbështesin këtë proces dhe i pasqyrojnë hapat e ndërmarrë në nivel më të lartë për përmbushjen e detyrimeve.

Indikatorët strukturorë fokusohen në miratimin e zgjidhjeve të nevojshme ligjore konform detyrimeve të marra; krijimin e strategjive dhe planeve të veprimit për avancimin e të drejtave të njeriut; ekzistimin dhe nevojën e krijimit të infrastrukturës plotësuese dhe mekanizmave të nevojshëm për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Indikatorët strukturorë (adoptuar nga OHCHR, 2012, faqe 34)

Indikatorët strukturorë ndihmojnë gjatë pasqyrit të pranimit, qëllimit dhe përkushtimit të shtetit që të ndërmarr masa konform detyrimeve të ndërmarrë për të drejtat e njeriut. Indikatorë të shpeshtë strukturorë janë:

- Instrumentet relevantë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut të cilët i ka ratifikuar shteti;
- Politikat, strategjitë, legjislacioni nacional, infrastruktura dhe mekanizmat të cilët ekzistojnë ose duhet të formohet/ndërtohen me qëllim të realizimit të detyrimeve të marra;
- Korniza kohore për miratimin e politikave, strategjive, legjislacionit, infrastrukturës dhe mekanizmave të nevojshëm;
- Procedurat ekzistuese dhe ato që duhet të zhvillohen për përmbushjen më të mirë të detyrimeve të marra nga bartësin e detyrave;
- Korniza kohore për miratimin e procedurave të nevojshme.

Indikatorët procesual

Këto indikatorë i matin aktivitetet të cilat bartësit e detyrave i marrin me qëllim të përmbushjes së detyrimeve. Ato vazhdimisht përdoren në matjen dhe vlerësimin e politikave dhe të masave konkrete të cilat bartësit e detyrave i marrin për transformimin e detyrimeve të marra në rezultate konkrete në terren. Indikatorët procesual i ndërlidhin masat dhe aktivitetet e ndërmarrë me arritjet konkrete, të cilat nga ana tjetër kur do të konsolidohen, do të duhet të rezultojnë me epilogët e dëshiruar. Këto indikatorë duhet të jenë të përshtatshëm me ndryshimet dhe në këtë mënyrë nga aspekti progresiv ta pasqyrojnë realizimin e të drejtave, por edhe të kontribuojnë në avancimin e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së shtetit.

Gjatë zgjedhjes dhe formulimit të indikatorëve procesual dy momente janë jashtëzakonisht të rëndësishëm: i pari ka të bëjë me indikatorin procesual që ta ndërlidhë Indikatorin strukturor në fjalë me indikatorin e epilogut, ndërsa i dyti ka të bëjë me atë që në mënyrë eksplicite ta pasqyroj aktivitetin konkret vis-à-vis bartësit e detyrave dhe detyrimeve të ndërmarrë.

Indikatorët procesual (adoptuar nga OHCHR, 2012, faqe 36)

Këta indikatorë, gjatë vlerësimit të aktiviteteve të marra të shtetit, e ndihmojnë që t'i transformoj detyrimet e marra në rezultate. Ky transformim bëhet përmes implementimit të politikave, strategjive, planeve të veprimit dhe masave dhe aktiviteteve të parashikuara konkrete. Formulimi i këtyre indikatorëve varet nga mjetet e përdorura gjatë implementimit të politikës dhe programit në fjalë, megjithatë indikatorë të shpeshtë procesual janë:

- Indikatorët për alokimin buxhetor të mjeteve për realizimin e të drejtës konkrete të njeriut;
- Përfshirja e grupeve të synuara me politikën, programet, me dokumentet dhe/ose aktivitetet strategjike dhe të veprimit;
- Parashitësit e pranuar dhe ankesat e paraqitura për shkeljen e të drejtave të njeriut, si dhe proporcioni i shkeljeve të shmangura;
- Masat e ndërgjegjësimit tek bartësit e detyrave për përmbushjen e detyrimeve edhe tek poseduesit e të drejtave për realizimin e të drejtave;
- Masat për stimulim (financiare dhe jo-financiare), të bartësve të detyrave, që t'i adresojnë problemet në fjalë gjatë realizimit të të drejtave të njeriut;
- Indikatorët për funksionimin e institucioneve konkrete (për shembull, Ombudsmeni, Qeveria, Kuvendi) ose të tërësive konkrete sistemore (për shembull, harmonizimi i ndërsjellë i ligjeve relevantë dhe akteve nënligjore, sa e mundëson legjislacioni realizimin e të drejtave të njeriut në praktikë).

Indikatorët e epilogut

Këta indikatorë i përfshijnë avancimet individuale dhe kolektive në realizimin e të drejtës së caktuar në kontekstin konkret dhe në këtë mënyrë e pasqyrojnë shkallën e gëzimit të atyre të drejtave. Kjo e nënkupton sublimimin e kohës dhe ndikimit të proceseve të ndryshëm, të cilët janë përfshirë në Indikatorët procesual të përbashkët ose të veçantë. Së këtejmi, ky lloj i indikatorëve nuk u përshtaten ndryshimeve të cilat ndodhin gjatë implementimit të politikave dhe programeve.

Indikatorët e epilogut i masin ndryshimet që ndodhin në një periudhë të caktuar kohore dhe i prezantojnë si rezultat konkret ose rezultate konkrete. Rrjedhimisht me këtë, ato kanë të bëjnë me aktivitetet të cilat implementohen me qëllim që të arrihen rezultatet e dëshiruara, si edhe me vet rezultatet e parashikuara. Së këtejmi, edhe formulimi i tyre varet nga qëllimet dhe epilogët që dëshirojmë t'i arrijmë.

Indikatorët e epilogut (adoptuar nga OHCHR, 2012, faqe 38)

Këta indikatorë ndihmojnë gjatë vlerësimit të rezultateve të përpjekjeve dhe aktiviteteve që i merr shteti me qëllim që të avancohet gëzimi i të drejtave të njeriut. Indikatorë të mundshëm të epilogut janë:

- Përqindja e numrit të caktuar të fëmijëve me aftësi të kufizuara, të përfshirë në arsimin e rregullt;
- Raste të denoncuara të diskriminimit brenda një periudhe të caktuar;
- Rritja në përqindje të aktiviteteve me karakter ndëretnik në proceset arsimore;
- Numri i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore;
- Numri i grave, viktimave të dhunës në familje, të denoncuara në ndonjërin nga strehëzat.

Kritere për seleksionimin e indikatorëve përkatës

Kritere për seleksionimin e indikatorëve (OHCHR, 2012, faqe 50)	
R	Relevant and reliable –Indikatorët duhet të jenë relevantë dhe të sigurt
I	Independent – Indikatorët duhet të jenë të pavarur nga subjekti i monitorimit , porë përmes prizmit të metodave të grumbullimit të të dhënave
G	Global and universally meaningful – Indikatorët duhet të vendosen në atë mënyrë që do të kenë kuptim dhe do të jenë të kuptueshëm edhe jashtë kufijve të shtetit në fjalë , por njëkohësisht duhet të jenë mjaft fleksibil që t'i përshtaten kontekstit në fjalë dhe të mund të disagregohen në baza të ndryshme
H	Human rights standards-centric – Indikatorët duhet të inkorporohen në kornizën normative dhe standardet për të drejtat e njeriut
T	Transparent, timely and time bound – Ata duhet të jenë transparent, në kohë të duhur që të adresojnë gjendje konkrete, si dhe të jenë të kufizuar në aspektin kohor , në mënyrë që të arrihen synimet e dëshiruara brenda një periudhe relativisht të shkurtër
S	Simple and specific – Indikatorët duhet të shprehen me gjuhë të thjeshtë dhe të jenë konkret

4.4. Vendosja e indikatorëve

Gjatë përzgjedhjes dhe përcaktimit të indikatorëve hapi më i rëndësishëm është lidhja e tyre me standardet konkrete për të drejtat e njeriut. Të dhënat dhe provat në dispozicion për performancat e indikatorëve konkret në mënyrë të njëjtë duhet të merren parasysh.

Para së gjithash, në kontekstin e të drejtës konkrete të njeriut, formulohet indikatori strukturorë përkatës. Për këtë shqyrtohen detyrimet të cilat i ka marrë shteti me instrumentet ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe gjenden të dhëna dhe informacione të cilat do të tregojnë se sa dhe në ç'mënyrë këto detyrime reflektohen në sistemin juridik nacional ndërsa pasta, i njëjti sa dhe në ç'mënyrë sanksionohet në politikat dhe programet të cilat i zbaton shteti.

Hapi i dytë konsiston me përcaktimin dhe formulimin e indikatorëve procesual. Këtu identifikohen të gjitha masat e përfshira në politikat dhe programet e institucioneve, bartësve të caktuar të detyrave dhe të mandateve të tyre, poseduesit konkret të të drejtave, struktura organizative, konteksti institucional dhe grykat eventualisht të ngushta, natyra e politikave dhe programeve ekzistuese dhe mangësitë e tyre etj. Në bazë të kësaj analize, identifikohet spektri i indikatorëve procesual të cilët do ta pasqyrojnë lidhjen midis Indikatorëve strukturorë dhe Indikatorëve të epilogut.

Hapi i fundit në vendosjen e indikatorëve konsiston me formulimin e Indikatorëve të epilogut. Gjatë artikulimit të tyre jashtëzakonisht e rëndësishme është që ato të ndërlidhen në mënyrë të qartë dhe të lehtë me gëzimin e të drejtës në fjalë, si dhe me indikatorët procesual. Këta indikatorë në numër janë më pak nga indikatorët procesual dhe e përmbajnë shumën kualitative dhe kuantitative të indikatorëve procesual.

Vendosja e indikatorëve (OHCHR, 2012, faqe 78)

Hapi 1	→	Indikatorët strukturorë	
		<ul style="list-style-type: none"> ■ Provizionet juridike kushtetuese dhe provizionet juridike tjera të brendshme për të drejtat aktuale ■ Politikat publike dhe mangësitë e tyre, në lidhje me të drejtën në fjalë ■ Korniza institucionale për implementimin e detyrimeve në lidhje me të drejtën konkrete 	
↓			
Hapi 2	→	Indikatorët procesual	Identifikimi i bartësve të detyrave dhe roleve të tyre; si dhe mandatet e institucioneve përkatëse
			Identifikimi i politikave dhe programeve relevante për sendërtimin e rezultateve të dëshiruara
			Identification of national and global good practices and gaps in the implementation of a certain right in the country
↓			
Hapi 3	→	Indikator i epilogut	identifikimi i epilogëve të dëshiruar që ndërlidhen me implementimin e detyrimeve të cilat rezultojnë nga të drejtat e njeriut, si dhe lidhja e tyre me proceset
Pasqyra / vlefshmëria e indikatorëve dhe nivelet e disagregimit, në përputhje me provat specifike për vendin konkret			

Kontekstualizimi i indikatorëve

Indikatorët për matjen e realizimit të të drejtave të njeriut është më se e nevojshme të dizajnohen për secilin kontest specifik në mënyrë të veçantë, të përcaktohen në mënyrë të saktë dhe konkrete, të bazohen në metodologjinë e parashikuar dhe harmonizuar (në bashkëpunim edhe me institucione të tjera edhe me sektorin qytetar dhe/ose me sektorin e biznesit), si dhe vazhdimisht të jenë të aksesshëm për të gjitha palët e interesuara dhe të kontribuojnë në popullatën e tyre. Kontekstualizimi i indikatorëve e mundëson ownership-in e tyre nga ana e shtetit, ndërsa procesi inkluziv dhe participativ i dizajnit të tyre e siguron cilësinë dhe relevancën e tyre.

Kontekstualizimi i indikatorëve (OHCHR, 2012, faqe 87)

Hapi 1	→	<ul style="list-style-type: none"> ■ Indikatorët strukturorë ■ Identifikimi i boshllëqeve në legjislacionin nacional vis-à-vis të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe detyrimeve të shtetit, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ■ Identifikimi i boshllëqeve në dokumentet e politikave publike në lidhje me problemin konkret, duke i marrë parasysh edhe praktikat më të mira ndërkombëtare ■ Identifikimi i praktikave zakonore dhe të institucioneve relevante nacionale për implementimin e detyrimeve të cilat burojnë nga të drejtat e njeriut
---------------	---	--

Hapi 2	→	<ul style="list-style-type: none"> ■ Indikatorët procesual ■ Kontekstualisht relativ dhe të fokusuar në nivelin lokal 	→	Identifikimi i grupeve të synuara me qëllim të artikullimit të indikatorëve konkret
		<ul style="list-style-type: none"> ■ Mund të nevojitet një numër më i madh i indikatorëve procesual 	→	Rafinimi i indikatorëve ilustrativ për programet ekzistuese
		<ul style="list-style-type: none"> ■ Fokusi mbi të dhënat administrative ■ Dizajnoni indikatorë procesual dhe intervenime plotësuese 	→	Fokusi mbi proceset buxhetorë nacional dhe lokal për meinstrimizimin e të drejtave të njeriut

Hapi 3	→	Indikatorët e epilogut Formulimi standard i këtyre indikatorëve, ka të bëjë me relevancën universale; ka mundësi të nevojitet adaptimi i tyre në grupet e synuara specifike lokale
---------------	---	--

Pasqyra / validimi i indikatorëve të bazuar në nevojën nga follow-up të rekomandimeve të dhëna në mekanizmat për të drejtat e njeriut dhe provave specifike të shtetit

Shembull: Matrica e indikatorëve

Matrica e indikatorëve për të drejtën e arsimit, përmes prizmit të arsimit inkluziv të nxënësve me aftësi të kufizuara

Katër kolonat e matricës në vijim i paraqesin sektorët kyç të cilët rezultojnë nga Faza 1 dhe 2 e metodologjisë së theksuar më lartë dhe kanë të bëjnë vetëm me temë konkrete. Në përputhje me natyrën dhe nevojat e intervenimit që do ta ndërmerri, do të ndryshojë numri, kompleksiteti dhe dimensionimi i kolonave. Mos harroni çështjet t'i thjeshtëzoni, por të mos e përjashtoni asnjërin nga sektorët e nevojshëm.

Tri rreshtat kryesorë në vijim e përfshijnë çdo nivel të indikatorëve dhe mund të përfshijnë indikatorë të cilët janë zhvilluar për shumicën e sektorëve ose për të gjithë sektorët (indikatorë të përbashkët), apo për një sektorë të veçantë (indikatorë sektorial). Përdorini të dyja llojet në përputhje me natyrën e intervenimit. Përfundimisht, duhet t'i keni parasysh lidhjet logjike ndërmjet indikatorëve, si dhe regresin e tyre nga indikatorët strukturorë në drejtim të indikatorëve të epilogut dhe anasjelltas.

	Arsimi i përgjithshëm fillor	Qasja në arsimin e mesëm dhe të lartë	Kurikulat dhe resurset arsimore	Mundësitë arsimore dhe liria
Indikatorët strukturorë	<ul style="list-style-type: none"> ■ Marrëveshjet e ratifikuara relevante ndërkombëtare të cilat e trajtojnë të drejtën e arsimit, përgjithësisht, si edhe ato që e trajtojnë arsimin inkluziv të nxënësve me aftësi të kufizuara; ■ Përfshirja kushtetuese e të drejtës së arsimit; ■ Përfshirja ligjore e të drejtës së arsimit, në përgjithësi, dhe të arsimit inkluziv për nxënësit me aftësi të kufizuara, veçanërisht, (e dyta e përfshinë ndalimin e diskriminimit, objektet e aksesshme dhe të arritshme shkollore (deri dhe në), kuadri mësimor dhe kuadri tjetër i domosdoshëm për realizimin e suksesshëm të arsimit inkluziv); ■ Korniza ligjore për vendosjen e institucioneve të posaçme arsimore për nxënësit me aftësi të kufizuara, si edhe për udhëheqjen e këtyre institucioneve nga personat me aftësi të kufizuara (nuk bëhet fjalë për “shkolla speciale”, në përputhje me kornizën ekzistuese nacionale ligjore, por bëhet fjalë për mundësitë e shmangies së parimit të lëvizjes së personave me aftësi të kufizuara “Asgjë për ne, pa ne” në sektorin e arsimit); ■ Numri i OQ-ve aktive në promovimin, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtës për arsim inkluziv të nxënësve me aftësi të kufizuara, si dhe fusha për angazhimin e tyre profesional (ndikimi, ndërgjegjësimi, ndërtimi i kapaciteteve, zhvillimi i materialeve edukative, përkujdesja e fëmijëve me aftësi të kufizuara, qendra të resurseve); 			
	<ul style="list-style-type: none"> ■ Korniza kohore dhe përfshirja e planit strategjik dhe planit të veprimit për arsim fillor falas dhe të detyrueshëm për të gjithë (në rastin tonë edhe arsimi i mesëm); ■ Korniza kohore dhe përfshirja e planit strategjik dhe planit të veprimit për të mundësuar arsim të plotë inkluziv për nxënësit me aftësi të kufizuara, si dhe dokumente që kanë të bëjnë me “shkollat speciale” për nxënësit me aftësi të kufizuara; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Korniza kohore dhe përfshirja e politikave nacionale arsimore për të gjithë, duke i përfshirë masat e përkohshme dhe /ose speciale për nxënësit me aftësi të kufizuara; ■ Korniza kohore dhe përfshirja e politikave nacionale arsimore për arsimin profesional dhe teknik; ■ Kurikula të standardizuara për arsimin në të gjitha nivelet – data e hyrjes në fuqi dhe përfshirja e tyre; ■ Numri ose përqindja e institucioneve arsimore, në të gjitha nivelet, të cilët mësojnë për të drejtat e njeriut, inkluzionin, diversitetin, si dhe numri i orëve për të njëjtën, si pjesë e kurikulës; ■ Numri ose përqindja e institucioneve arsimore të cilat kanë sistem për inkuadrimin e kuadrit për mbështetje të proceseve arsimore të nxënësve me aftësi të kufizuara (këtu bëjnë pjesë asistentët personal në proceset arsimore, asistentët edukativ etj.); ■ Numri ose përqindja e institucioneve arsimore me mekanizma që nxënësit të marrin pjesë në punët që i prekin ata dhe të miratojnë vendime në lidhje me të njëjtën, si dhe këto mekanizma a kanë nënmechanizma të cilët e sigurojnë përfshirjen edhe të nxënësve me aftësi të kufizuara; 		

<ul style="list-style-type: none"> ■ Proporcioni i ankesave/parashtresave të pranuar lidhur me të drejtën e arsimit inkluziv të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë trajtuar dhe për të cilat është marrë qëndrim pozitiv nga Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ombudsmani, Gjykata Kushtetuese dhe/ose mekanizma të tjerë, si dhe atë se për cilën pjesë të tyre Qeveria ka vepruar në mënyrë efikase; ■ Proporcioni midis BPV dhe mjeteve të akorduara buxhetore, në të gjitha nivelet e arsimit, në përgjithësi, si dhe cila përqindje e proporcionit është dedikuar për sigurimin e arsimit inkluziv të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara; ■ Lartësia e ndihmës së pranuar zhvillimore, e dedikuar për arsimin, në përgjithësi, dhe në cilën lartësi të përqindjes e njëjta është dedikuar për sigurimin e arsimit inkluziv të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara; 			
<ul style="list-style-type: none"> ■ Proporcioni i nxënësve të regjistruar me aftësi të kufizuara vis-à-vis nxënësve pa aftësi të kufizuara; ■ Përqindja e kalimit të nxënësve me aftësi të kufizuara në klasë më të avancuar; ■ Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara të regjistruar në shkollat publike; ■ Proporcioni i nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët përdorin programe për mbështetje ose stimulime financiare për arsimin fillor; ■ Proporcioni i shkollave publike të cilat kanë përfshirë shpenzime plotësuese për nxënësit, përveç mjeteve të domosdoshme minimale; ■ Proporcioni i mësimdhënësve të cilët janë të trajnuar dhe kualifikuar plotësisht për punë me nxënës me aftësi të kufizuara; ■ Proporcioni i shkollave të cilat janë plotësisht të aksesshme dhe të qasshme për nxënësit me aftësi të kufizuara; ■ Proporcioni i shkollave të cilat kanë kuadër të mjaftueshëm për mbështetjen e arsimit papengesa dhe cilësor të nxënësve me aftësi të kufizuara; ■ Proporcioni i nxënësve me aftësi të kufizuara në klasën e parë të cilët kanë vizituar ndonjë lloj të arsimit parashkollor; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Përqindja e kalimit të nxënësve me aftësi të kufizuara nga arsimi i rregullt fillor në arsimin e rregullt të mesëm; ■ Përqindja e kalimit të nxënësve me aftësi të kufizuara në klasë më të avancuar; ■ Përqindja e kalimit të nxënësve me aftësi të kufizuara nga arsimi i rregullt i mesëm në arsimin e lartë; ■ Proporcioni i shpenzimeve për një nxënës në arsimin e mesëm dhe të lartë, vis-a-vis konsumit mesatar vjetor të një familjeje, dhe indikator i njëjtë për nxënësit me aftësi të kufizuara; ■ Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët pranojnë grante, bursa ose ndonjë lloj tjetër të mbështetjes; ■ Proporcioni i mësimdhënësve të cilët janë trajnuar dhe kualifikuar plotësisht për punë me nxënës me aftësi të kufizuara; ■ Proporcioni i shkollave të cilat kanë kuadër të mjaftueshëm për mbështetje të arsimit papengesa dhe cilësor të nxënësve me aftësi të kufizuara; ■ Proporcioni i nxënësve me aftësi të kufizuara, të regjistruar në programet profesionale dhe teknike në arsimin e mesëm dhe në atë pas arsimit të mesëm; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Proporcioni i institucioneve arsimore të cilat janë në përputhje me kërkesat nacionale për objekte të aksesshme dhe të qasshme, me proceset dhe kurikulat arsimore; ■ Revizion periodik i kurikulave në të gjitha nivelet arsimore; ■ Avancimi i përfshirjes së të drejtave të njeriut në kurikulat; ■ Numri i shkollave, të përfshira dhe të përjashtuara nga proceset arsimore në periudhën konkrete; ■ Paga mesatare e mësimdhënësve si përqindje e pagës minimale në nivel nacional; ■ Numri i mësimdhënësve të cilët vizitojnë trajnime për punë me nxënës me aftësi të kufizuara dhe proporcioni i tyre me numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve; ■ Proporcioni i numrit të nxënësve për një mësimdhënës në çdo nivel të arsimit, veçanërisht duke e përfshirë edhe proporcionin e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara për një mësimdhënës; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Përqindja e institucioneve arsimore të cilat kanë pranuar koncepte bashkëkohore të arsimit (për shembull, mësimi aktiv), numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të përfshirë në këto shkolla dhe proporcioni i numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara në shkolla tjera; ■ Përqindja e personave të rritur me aftësi të kufizuara të cilët janë mbuluar me programe arsimore bazike; ■ Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët mësojnë në distancë, por e vazhdojnë arsimin e tyre; ■ Numri i institucioneve arsimore të themeluara dhe udhëhequra nga persona me aftësi të kufizuara, të cilat janë të njohura nga shteti dhe publiku (këtu nuk bëjnë pjesë organizatat për përkujdesje); ■ Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët e kalojnë trajnimin profesional që të hyjnë më lehtë në tregjet e hapura të punës, në institucionet publike dhe në ato të cilat janë të mbështetura me mjete publike; ■ - Përqindja e nxënësve të cilët përdorin kompjuterë personal;

Indikatorët e epilogut

<ul style="list-style-type: none"> ■ Proporcioni midis nxënësve meshkuj dhe femra me aftësi të kufizuara në një klasë; ■ Proporcioni i nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët e kryejnë arsimin fillor; ■ Përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara të moshës shkollore të cilët nuk shkojnë në shkollë; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Proporcioni midis nxënësve meshkuj dhe femra me aftësi të kufizuara në një klasë, në arsimin e mesëm dhe të lartë; ■ Proporcioni i nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët e kryejnë arsimin e mesëm; ■ Numri i studentëve me aftësi të kufizuara të cilët i kryejnë studimet universitare në 1000 banorë; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Objekte të avancuara arsimore, në të gjitha nivelet e arsimit, të cilët janë plotësisht inkluziv për nxënësit me aftësi të kufizuara; ■ Numri i objekteve arsimore të cilët janë bërë plotësisht inkluziv për nxënësit me aftësi të kufizuara, në periudhën konkrete; 	<ul style="list-style-type: none"> ■ Proporcioni i nxënësve me aftësi të kufizuara, me diploma profesionale ose universitare , me të dhëna të veçanta për gratë/vajzat me aftësi të kufizuara, për llojin e aftësisë së kufizuar dhe për grupe të tjera relevante të synuara;
<ul style="list-style-type: none"> ■ Shkalla e edukimit tek personat e rinj dhe të rritur me aftësi të kufizuara (lexim, shkrim, të folurit, matematikë, zgjidhje të problemeve, si dhe aftësi të tjera jetësore. 			

BIBLIOGRAFIA

- Abramoviç, Viktor. Përafrimi në Qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut, të strategjive dhe politikave zhvillimore, CEPAL Review 88 (ECLAC), 2006
- Darou dhe Tomas. Fuqia, të kapurit dhe konflikti: Përgjegjësia e bazuar mbi të drejtat në bashkëpunimin zhvillimor, 2005
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen nga Tortura dhe Trajtimi Johuman, Poshtërues ose Ndëshkues. E aksesshme në: <https://rm.coe.int/16806dbac2>
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E aksesshme në: https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf
- Karta Sociale Evropiane (e rishikuar). E Aksesshme në: <http://www.mtsp.gov.mk/evropska-socijalna-povelba.nsp>
- Jakob Kirkeman Boesen dhe Tomas Martin. Zbatimi i qasjes së bazuar në të drejtat – Udhëzues inspirativ për shoqërinë civile, Instituti për të Drejtat e Njeriut - Danimarkë, 2007
- Joakim Teis. Monitorimi dhe evaluimi të bazuara në të drejtat – Dokument për diskutim, “Shpëtoni Fëmijët”, 2003
- Komiteti për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Koment i përgjithshëm 3, Natyra e detyrimeve të vendeve anëtare (sesioni i pestë, 1990), U.N. Doc. E/1991/23, aneksi III (1991), ribotuar në Kompilim me komentet e përgjithshme dhe rekomandimet e përgjithshme të miratuara nga autoritetet kontraktuese për të drejtat e njeriut, U.N. Doc. HRI/GEN/1/Rev. 6 at 14 (2003)
- Magdalena Sepulveda Karmona. Raporti i Raportuesit Special për Varfërinë Ekstreme dhe për të Drejtat e Njeriut faqe. 7. I aksesshëm në: https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/26/28 [i aksesuar më datë: 24.06.2020]
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. I aksesshëm në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx> [i aksesuar më datë 24.06.2020]
- OHCHR. Indikatorët e të drejtave të njeriut – udhëzues në matjen dhe implementimin, 2012
- OHCHR. Realizimi i të drejtave të njeriut përmes buxheteve shtetërorë, 2017
- OHCHR. Pyetje të parashtruara shpesh për qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut në bashkëpunimin zhvillimor, 2006
- OKB Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. E/C.12/2001/10, paragrafi 8
- OKB. Qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut në bashkëpunimin zhvillimor – Në kuptimin e ndërsjellë midis agjencive të OKB, 2003
- OECD/DAC. Fjalor i nocioneve kryesore gjatë evaluimit dhe menaxhmentit të bazuar në rezultate, 2002. I aksesshëm në: <https://www.oecd.org/dac/evaluation/2754804.pdf>
- OHCHR. Realizimi i të drejtave të njeriut përmes buxheteve shtetërorë, 2017, HR/PUB/17/3
- Karta e OKB. E aksesshme në: <https://www.un.org/en/sections/un-charter/chapter-i/index.html>

- Konventa për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale. E aksesshme në:
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016800c130f>
- Toraja Ahmed Obaid. Shënime për politikat e implementimit të QBDNj në programimin e UNFPA, 2004, UNFPA/CM/04/7
- UNDG. Draft Pasqyrë e shkurtër teknike, faqe 1. E aksesshme në:
www.undg.org/docs/9871/Technical-brief---Outcomes-v2.0-Oct07.doc
- UNDP. Meinstrimizimi i të drejtave të njeriut në politikat zhvillimore dhe programimin: Përvojat e UNDP, 2012
- UNDP Argjentinë. Udhëzues për planifikimin lokal duke e përdorur qasjen e bazuar mbi të drejtat e njeriut, 2011
- UNDP Vietnam. Mekanizma për Qasjen e Bazuar mbi të Drejtat e Njeriut, 2009
- UNESCO. Programimi, menaxhmenti, monitorimi dhe raportimi të bazuara në rezultate – Qasja e aplikuar në UNESCO: Parime udhëzuese, 2007
- UNICEF Finlandë. Hyrje në Qasjen e Bazuar mbi të Drejtat e Njeriut – Udhëzues për OQ-të finlandeze dhe partnerët e tyre, 2015
- UNFPA. Manual për procedura dhe politika; Programi, Hyrja në Procesin e Programimit të Vendit, 2003
- UNFPA. Qasja e Bazuar mbi të Drejtat e Njeriut në Programimin, 2010
- UNFPA. Korniza për përgjegjësi, Raporti i Drejtorit Ekzekutiv, DP/FPA/2007/20
- UNCT. Mekanizma për QBDNj Vietnam, 2009
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e OKB. E aksesshme në:
<https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>
- FLAK Brifing: Qasja e Bazuar mbi të Drejtat e Njeriut në buxhetimin, 2014
- <http://hrbaportal.undg.org> [e aksesuar midis: 13.06.2020 dhe 20.06.2020]
- <https://indicators.ohchr.org/> [e aksesuar më datë: 20.06.2020]

